



NJOHJA DHE ZBATIMI I STANDARDEVE TË BARAZISË GJINORE NË PROCESIN GJYQËSOR

*Raport mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatave të shkallës së
I-rë, të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë*

1 Janar 2011- 1 qershor 2012

Përgatitja dhe botimi i këtij raporti u mbështet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Qeveria e Suedisë. Idetë e shprehura nga autorët e këtij botimi, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e UNDP-së apo të Qeverisë suedeze.

Tiranë, Dhjetor 2013

Ky raport hartohet në kuadrin e zbatimit të projektit: *“Përgatitja e kërkesë padive strategjike me qëllim forcimin e të drejtave të grave dhe rritjen e aksesit të tyre në mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë”*. Projekti është zbatuar nga QNL, përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore për periudhën 1 janar 2011- 1 qershor 2012. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD ka mbështetur financiarisht këtë projekt.

Përgatitën Raportin:

Prof. Dr. Arta Mandro – Balili

Av. Aurela Bozo

Prof. Dr. Aurela Anastasi

Monitoruan vendimet gjyqësore:

Av. Besa Saraci, Tiranë

Av. Jonida Gezka, Tiranë,

Av. Iris Aliaj, Tiranë,

Av. Erind Mërkuri, Durrës

Av. Klajdi Mone, Vlorë

Av. Edlira Grabova, Shkodër

Raporti u përkthye nga: Simon Ziu

© Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Arti grafik: BlueLine studio

Shtypur: Në shtypshkronjën “Dajti 2000”, Tiranë

Përmbajtja e Lëndës

i. Falënderim	5
ii. Shkurtime.....	6
iii. Metodologjia.....	7
iv. Përmbledhje e gjetjeve kryesore	9
v. Përmbledhje e përfundimeve dhe rekomandimeve.....	17

PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT

I. Referimi i standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare lidhur me barazinë gjinore dhe mos diskriminimin në vendimet e monitoruara.....	20
--	-----------

1.1. Shkurt mbi standardet ligjore objekt i monitorimit.....	20
---	-----------

• Konventa CEDAW	20
• Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)	21
• Protokolli 7 i KEDNJ dhe përkatësisht neni 5 i tij	21
• Protokolli 12 i KEDNJ, përkatësisht neni 1 i tij.....	21
• Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” [Ligji Nr. 104/2012]	22
• Konsiderata të përgjithshme të GJEDNJ	22
• Ligji “Mbi barazinë gjinore në shoqëri” [Ligji Nr.9970/28.7.2008].....	22
• Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” [Ligji nr. 10221/4.2.2010]	23
• Mbrojta juridiko- civile dhe juridiko penale ndaj dhunës në familje.....	23

1.2. Zbatimi/referimi i standardeve ndërkombëtare dhe jurisprudencës së GJEDNJ në vendimet gjyqësore të monitoruara	24
--	-----------

II. Impakti gjinor në vendimet me objekt zgjidhje martesë dhe pasojat e tyre.....	26
--	-----------

2.1. Disa konkluzione nga monitorimi i vendimeve me objekt zgjidhjen e martesës	27
--	-----------

2.2. Disa nga shkaqet e evidentuara për zgjidhjen e martesës dhe stereotipat gjinore	35
---	-----------

2.3. Pasojat e vendimeve të zgjidhjes së martesës kundrejt bashkëshortëve dhe ushtrimi i përgjegjësisë prindërore.....	36
---	-----------

2.4. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore.....	45
--	-----------

III. Gjetje kryesore nga monitorimi i vendimeve gjyqësore dhe praktikës së QNL-së për çështjet me objekt lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.....	47
---	-----------

IV. Gjetje paraprake nga monitorimi i vendimeve gjyqësore penale.....	53
<i>4.1. Çështjet me objekt zbatimin e nenit 130/a, " Dhuna në familje" të KP, të ndryshuar.</i>	<i>53</i>
<i>4.2. Gjetjet nga monitorimi i zbatimit të Nenit 320 të Kodit Penal "Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës" dhe Nenit 321 të Kodit Penal "Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës", i ndryshuar.</i>	<i>54</i>
<i>4.3. Gjetje nga monitorimi i vendimeve penale lidhur me zbatimin e nenit 113 i K.Penal "Prostitucioni" ndryshuar</i>	<i>55</i>
<i>4.3.1. Analiza e një rasti konkret dhe dhënia e opinioneve juridike të QNL mbi antikushтетutshmërinë e nenit 113 të KP: Rasti B.Q.....</i>	<i>57</i>
V. Monitorimi i praktikave të institucioneve të Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Avokatit të Popullit lidhur me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.....	60
Bibliografi dhe baza ligjore	61

i. Falënderim

Ky raport është hartuar në kuadrin e zbatimit të projektit: *“Përgatitja e kërkesë padive strategjike me qëllim forcimin e të drejtave të grave dhe rritjen e aksesit të tyre në mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë”*. Projekti është zbatuar nga QNL, përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë për periudhën janar 2011- 1 qershor 2012 dhe është mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD.

QNL shpreh falënderimet e sinqerta për të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij projekti. Një falënderim i veçantë shkon për anëtarët e skuadrës *pro bono*, studentë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës: Elisabeta Gjoni, Arjola Azizaj, Marsila Osmani, Andri Gjini, Agim Gapi, Elton Zeneli, Krisi Anastas, Kristi Xhemalaj, Xhon Skënderi, Eva Veliu, Sajmira Kopani, Rudina Kullolli, Gëzim Spahiu, Anisa Muzhaka dhe Arfjona Koçibellinj.

Dëshirojmë të falënderojmë gjithashtu Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, PNUD, i cili financoi projektin dhe përgatitjen e botimit të këtij raporti. Një falënderim i veçantë i drejtohet Znj. Emira Shkurti, për këshillat dhe sugjerimet që na ka dhënë në mënyrë të vazhdueshme.

QNL shpreh falënderimet dhe mirënjohjen ndaj të gjitha institucioneve dhe aktorëve që morën pjesë gjatë diskutimeve të rezultateve të monitorimit duke sugjeruar dhe bërë rekomandime konkrete dhe efektive për përmirësimin e të drejtave të grave dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional. U drejtohemi veçanërisht, kryetarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore të monitoruara, për lehtësitë që na krijuan në këtë proces, si dhe gjyqtarët e seksioneve familjare të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Vlorë, dhe Shkodër. Gjithashtu, organizatat jofitimprurëse meritojnë një përsëritje për kontributin e tyre në tryezat e diskutimeve dhe parashitjet e rëndësishme të konkretizuara me rastet e trajtuara prej tyre.

Për më tepër, dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen dhe falënderimet e përzemërta Prof. Dr. Arta Mandro, e cila me përvojën e saj, dha një ndihmesë vendimtare në përpunimin e të dhënave të monitorimit dhe për përgatitjen e raportit.

Falënderojmë të gjithë stafin e juristeve dhe avokateve të QNL-së, që ndanë përvojat e tyre dhe e pasuruan raportin në aspektet cilësore.

QNL shpreson që gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e këtij studimi të jenë të dobishme për të gjithë aktorët e angazhuar në çështjet e barazisë gjinore dhe të mosdiskriminimit.

Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi
Drejtoreshë Ekzekutive

ii. Shkurtime

KEDNJ	Konventa Evropiane <i>për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut</i> .
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut [Strasburg].
CEDAW	Konventa Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.
K.P	Kodi Penal i RSh miratuar me Ligjin Nr.7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar.
K.Pr.P	Kodi i Procedurës Penale të RSh miratuar me Ligjin Nr.7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar.
K.Pr.C	Kodi i Procedurës Civile të RSh miratuar me Ligjin Nr.8116, datë 29.3.1996, i ndryshuar.
KF	Kodi i Familjes [2003] miratuar me Ligjin Nr.9062, datë 8.5.2003.
GjRrGj	Gjykata e Rrethit Gjyqësor.
LDHF	Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” [2006 ndryshuar].
UM/UMM	Urdhër mbrojtjeje; Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje.
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.
QNL	Qendra Për Nisma Ligjore Qytetare.

iii. Metodologjia

Në kuadrin e zbatimit të projektit “Përgatitja e kërkesë padive strategjike me qëllim forcimin e të drejtave të grave dhe rritjen e aksesit të tyre në mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë”, zbatuar nga QNL, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD është kryer një monitorim i vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2011- 1 qershor 2012. Në aspektin metodologji, realizimi i këtij monitorimi përfshiu disa hapa kryesorë si:

- ❑ *Identifikimi i gjykatave.* Nisur nga interesi i identifikimit të problematikës tipike, monitorimi u përqendrua në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore: Tiranë, Durrës, Shkodër, dhe Vlorë;
- ❑ *Përgatitja e skedës monitoruese.* Për këtë një grup ekspertësh të QNL-së punoi për aspektet e kompozimit të elementëve të skedës monitoruese. Për të identifikuar një model në të cilin të përfshiheshin elementë gjithëpërfshirës, u pilotuan disa vendime gjyqësore. Gjithashtu, lidhur me përmbajtjen e skedës u mor edhe mendimi i avokatëve. Kështu u konkludua se çfarë kjo skedë duhet të monitorojë.
- ❑ *Krijimi i grupit të monitoruesve.* QNL bëri përzgjedhjen e avokatet monitorues në rrethet gjyqësore Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Tiranë. Në këtë përzgjedhje si kriter seleksionues u konsiderua:
 - Niveli i njohurive dhe kompetenca në çështjet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit;
 - Përvojat e kandidatëve kundrejt ofrimit të shërbimit ligjor për çështjet objekt monitorimi;
 - Përvojat e kandidatëve kundrejt kryerjes së monitorimeve të ngjashme në lidhje me efektivitetin e sistemit të drejtësisë parë nga perspektiva gjinore;
- ❑ *Trajnim i monitoruesve.* Me qëllim përdorimin e një metodologjie të unifikuar dhe kuptimin adekuat të skedës monitoruese u bë trajnimi i stafit monitorues. Gjithashtu u organizua një trajnim me anëtarët e skuadrës pro bono, studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Tiranë, me qëllim përfshirjen e tyre aktive në monitorim.
- ❑ *Monitorimi i praktikave të QNL.* Gjetjet e monitorimit u pasuruan me praktikat e klientëve të ndjekura nga QNL-së në çështjet objekt monitorimi të fokusuara edhe këto në periudhën Janar- Dhjetor 2011, Janar -Qershor 2013. Po kështu u shfrytëzuan të dhënat e nxjerra nga seancat gjyqësore për çështjet për të cilat ofrohet shërbim ligjor falas nga avokatet e QNL-së dhe avokatët monitorues në rrethe. U shfrytëzuan edhe raporte dhe eksperiencia të mëparshme të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare, në lidhje me monitorimin e gjykatave të rretheve gjyqësore gjithnjë me fokus në aspektet barazisë gjinore.

Objekti i çështjeve gjyqësore të monitoruara

- ❑ *Monitorimi i standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin:* për këtë, të gjitha vendimet gjyqësore të periudhës objekt monitorimi, disa çështjet në proces dhe praktikat e klientëve të QNL janë fokusuar në citimin e standardeve të përcaktuara nga: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Konventa CEDAW; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut përkatësisht neni 14 i saj dhe Protokollin 12 i saj, si dhe akte

të tjera ndërkombëtare në lidhje me barazinë gjinore, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Është analizuar vendi që zënë këto akte në bazën ligjore të kërkesë padive si dhe në arsyetimin e vendimeve;

- ❑ *Monitorimi i aspekteve gjinore në vendimet gjyqësore në çështjet me objekt zgjidhjen e martesës dhe pasojat e zgjidhjes së martesës.* Këtu jemi ndalur në aksesueshmërinë e gjykatës nga bashkëshortët, pasojat kundrejt ndarjes së pasurisë bashkëshortore dhe pasurisë nga bashkëjetesa; çështje të institutit të amësisë dhe atësisë; probleme të detyrimit për ushqim; aspekte të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës; etj;
- ❑ *Monitorimi në aspektin gjinor në disa vendime penale:* këtu jemi ndalur në vepra penale ushtrimi i prostitucionit; marrëdhëniet seksuale me dhunë; trafikimi i grave dhe fëmijëve etj. Zbatimi i ndryshimeve ligjore në Kodin penal, përkatësisht në vitin 2012 dhe 2013 aq sa periudha e monitorimit e mundësonte, bëri që në objektin e monitorimit të përfshihej neni 130/a i Kodit Penal 'Dhuna në familje'; neni 43 (a) i kodit Penal 'Humbja e përgjegjësisë prindërore'; neni 121 (a) i Kodit Penal, 'Përndjekja'; neni 321 I Kodit Penal, 'Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës'.
- ❑ Monitorimi i ankesave të paraqitura tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe monitorimi i praktikave të Avokatit të Popullit në Shqipëri, në lidhje me barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

iv. Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Miratimi i legjislacionit antidiskriminim dhe ratifikimi i konventave ndërkombëtare që nënvizojnë parimet e standardet e barazisë dhe mosdiskriminimit është vetëm fillimi i përpjekjeve për të njohur këto të drejta. Zbatim i tyre është një rrugë e gjatë dhe në këto përpjekje pa dyshim që pushteti gjyqësor luan një rol të rëndësishëm.

Duke qenë standarde ende të brishta e të panjohura, ka gjasa që shumë të drejta të cenuara të mos shkojnë fare në gjykatë e të mos kërkohen në kuadrin e mbrojtjes nga diskriminimi. Kjo ndodh edhe kur këto të drejta janë cenuar në mënyrë të hapur. Nga ana tjetër, qëndron rreziku që, edhe kur paraqiten si të tilla, pra si të drejta të cenuara e të vëna në rrezik, në procesin e gjykimit mund të reduktohen në çështje jo të rëndësishme e gati - gati të zbehen e veniten duke u lënë të pambrojtura. Pa dyshim që në këtë proces të përpjekjeve të konsolidimit të barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor ka edhe përvoja pozitive të cilave duhet dhënë merita me qëllim të njihen e të pasohen nga të tjera.

Juridikisht bashkëshortët gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësish në disa momente dhe aspekte të rëndësishme të jetës bashkëshortore. Këtë e evidentojmë në tërësinë e aspekteve formale dhe të kushteve që kërkohen për lidhjen e martesës [konstituimit të martesës si akt]; gjatë martesës [martesës si marrëdhënie], dhe në rast të zgjidhjes së saj [si një nga mënyrat e mbarimit të martesës]. Në gjithë këto procese jetësore e ligjore ndodhin edhe fakte që çojnë në cenimin apo mosrespektimin e së drejtave. Për nga vet natyra e tyre, në marrëdhëniet familjare e martesore, që ligji të bëhet realitet kërkohet që barazia të sigurohet në marrëdhëniet midis vetë bashkëshortëve, në lidhje me personin e tyre, me njëri tjetrin dhe me pronën, si edhe në lidhjet e tyre me fëmijët e tyre. Pra, vet bashkëshortët dhe anëtarët e familjes duhet të jenë protagonistë të mbrojtjes së standardeve të barazisë e mosdiskriminimit gjatë zhvillimit të jetës familjare e martesore. Në mbrojtjen e të drejtave të bashkëshortëve një rol të veçantë kanë edhe autoritetet. Kështu, është detyrë e autoriteteve gjyqësore si autoritete publike që kur marrin një vendim për ndarjen e pronës, në rast mbarimit apo zgjidhjes së martesës, kur marrin një vendim lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, apo në rastin e një urdhri mbrojtjeje lidhur me dhunën në familje, etj, të kenë parasysh në mënyrë të qartë të gjithë faktorët përkatës që mund të çojnë në diskriminim apo pabarazi kundrejt pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës, dhuna në familje, etj.

Diskriminimi gjinor si i tillë është i lidhur ngushtë edhe diskriminime që lidhen me statusin marital [të qenurit beqar/e, i/e ve, i/e martuar ose i/e divorcuar]. Po kështu në diskriminim ndikojnë edhe gjendja familjare ose martesore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësitë prindërore, etj shkaqe që hasen dukshëm ose mund të hasen si ‘të fshehura’ gjatë gjykimit të çështjeve familjare. Sipas ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 7 nën titullin ‘Mbrojtja nga diskriminimi’, nënvizohet se “përbën diskriminim, çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ... që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash”. Kjo do të thotë se eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë duhet të garantohet për cilindo në çdo proces e procedurë me cilindo autoritet dhe ca më shumë në vendimet gjyqësore.

Jeta familjare e martesore ka një ndikim të madhe në cilësinë e jetës së çdo individi. Ndaj

dhe fokusi i monitorimit ishte të shihnim familjen dhe anëtarët e saj. Qëllimi i monitorimit ishte të sillnim në vëmendje përmes rasteve e shifrave atë që ndodh në gjykatë, ose më saktë atë që përcillet në gjykatë dhe bëhet objekt i një konflikti gjyqësor çka nuk mund të kuptohet nga analiza e një rasti të vetëm.

Monitorimi u përqendrua në 4 gjykata të rretheve gjyqësore: Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër. Në këtë mënyrë, në procesin e përzgjedhjes së kampionit, QNL u kujdes edhe për shpërndarjen gjeografike të informacionit dhe të të dhënave të monitorimit, por edhe në ato gjykata që kanë aktivitet gjyqësor të spikatur për shkak të numrit të çështjeve të paraqitura në to. Monitorimi u përfshi në një hark kohor prej 17 muaj që përfshinë periudhën nga 1 Janar 2011 deri në 31 Maj 2012. Theksojmë faktin se në këtë proces, hasëm vështirësi për njohjen e vendimeve të gjykatave të rretheve Durrës, Vlorë Shkodër, pasi vetëm Gjykata e Tiranës ofron mundësi për njohjen e vendimeve gjyqësore përmes internetit. Prandaj, është e nevojshme që të merren masa për forcimin e transparencës së pushtetit gjyqësor përmes publikimit të vendimeve gjyqësore në të gjitha rrethet gjyqësore të Shqipërisë, natyrisht, duke respektuar të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale të palëve.

Sa i përket objektit të monitorimit vëmendja u përqendrua në vendimet gjyqësore dhe praktikës së QNL-së për çështjet me objekt:

- Standardet e ndërkombëtare e vendase lidhur me barazisë gjinore në çështjet familjare;
- Zgjidhja e martesës dhe pasojat lidhur me pasurinë bashkëshortore, përgjegjësinë prindërore, etj;
- Impakti gjinor në çështje që lidhen me urdhrat e mbrojtjes;
- Zbatimi i disa dispozitave të Kodit Penal të tilla si neni 130/a, 113, 320, 321 që kanë impakt gjinor;
- Monitorimi i institucioneve të pavarura si Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi dhe Avokati i Popullit.

Tabela e përgjithshme e vendimeve të monitoruara sipas objektit dhe gjykatave

Gjykatat	Sipas Objektit			Periudha 1 Janar 2011-31Maj 2012
	Zgjidhje Martese	UM	Çështje penale si neni 130/a KP, etj	
Tiranë	1092	421	138	
Vlorë	295	81	Nuk ka	
Shkodër	336	83	Nuk ka	
Durrës	423	232	7	
Totali	2146	817	145	

Gjetjet mbi njohjen dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare: një nga objektivat e monitorimi ishte evidentimi i gjendjes së referimit dhe zbatimit të standardeve ndërkombëtare e vendase lidhur me barazinë gjinore e mosdiskriminimin *në jetën familjare e martesore. Kështu, në këtë raport përmbledhës të gjetjeve, i lamë hapësirë të moderuar listës së akteve normative në të cilën gjejmë pasqyrim këto standarde. Duke qenë se diskriminimi në përgjithësi dhe ai me bazë gjinore në veçanti është një fenomen endemik, global dhe rajonal që cenon thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vëmendja e kujdesi për të vendosur disa standarde minimale në instrumentet ndërkombëtare, ka qenë e vazhdueshme. Në këtë drejtim vendi ynë ka bërë një sërë përparimesh dhe është treguar i pakursyer në ratifikimin e tyre. Si të tilla instrumente me rëndësi*

të veçantë në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit përmendim: Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW¹); KEDNJ e veçanërisht nenin 14 të kësaj Konvente dhe Protokollin 12 të saj; Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), etj.

Sipas Kushtetutës, pas ratifikimit, çdo konventë bëhet pjesë e legjislacionit të brendshëm. Nëse nuk është e vetëzbatueshme, atëherë një ligj duhet ta bëjë të mundshme këtë. Kuvendi ka ratifikuar së fundmi edhe Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”² e njohur si Konventa e Stambollit. Ndërkohë përparimet janë evidente edhe në kuadrin ligjor të brendshme.

Të dhënat e monitorimit për standardet ndërkombëtare duket se janë përqendruar në vendimet e GjRrGj Tiranë. E themi këtë sepse monitorimi nuk nxori të dhëna lidhur me referimin e standardeve ndërkombëtare në vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, referuar tek vendimet sipas bazës ligjore objekt monitorimi, kemi vëmë re se në këto vendime të monitoruara nuk përmenden fare instrumente të tilla si Konventa CEDAW apo Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” etj. Lidhur me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ndërsa nuk ka referime në standardet dhe jurisprudencën ndërkombëtare për periudhën e monitoruar, duket se në vendime të vitit 2013 po bëhet më shumë kujdes për të pasqyruar ekstrakte të Kushtetutës së RSH apo të instrumenteve ndërkombëtare.

Si përfundim, siç vihet re, në çështjet e monitoruara, ende zë pak vend referimi në standardet ndërkombëtare dhe të jurisprudencës së GJEDNJ. Të njëjtën themi edhe për zbatimin e ligjeve të tilla si “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe “Për barazinë gjinore në shoqëri” ndonëse efekti i tyre është më evident në çështje të së drejtës publike.

Impakti gjinor në vendimet me objekt zgjidhje martesë dhe pasojat e tyre: Synimi i monitorimit të praktikës gjyqësore është evidentimi i aspekteve pozitive por edhe i mangësive lidhur me respektimin e standardeve të barazisë gjinore në momente kaq delikate siç është zgjidhja e martesës dhe pasojave që vijnë prej saj. Nga mënyra se si qëndrojnë dispozitat e Kodit të Familjes vëmë re tri shtylla kryesore të parimit të barazisë: atë të barazisë midis burrit dhe gruas si bashkëshortë; atë të barazisë midis burrit dhe gruas si nëna dhe ati, pra si prindër kundrejt fëmijëve të tyre; atë të barazisë së fëmijëve pavarësisht statusit marital të prindërve.

NUMRI I VENDIMEVE TË MONITORUARA ME OBJEKT ZGJIDHJE MARTESE SIPAS GJYKATAVE DHE VITEVE				
Gjykatat	Tiranë	Durrës	Vlorë	Shkodër
2011	618	272	213	257
2012	474	151	82	79

Në rang vendi, statistikave tregojnë se ka një tendencë në rritje të numrit të çështjeve me objekt zgjidhje martesë³.

Disa nga konkluzionet e dala nga monitorimi i vendimeve me objekt zgjidhjen e martesës

1 Konventa e CEDAW-ut e 1979 është ratifikuar nga 185 shtete. **Shqipëria e ratifikoi CEDAW-n më 1993** (Ligji 1769/9.11.1993)

2 LIGJ Nr. 104/2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

3 Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 2010. Në këtë dokument gjenden të dhëna edhe për periudhat e mëparshme.

përfshijnë:

- Gruaja si bashkëshorte po merr gjithnjë e më shumë kurajën për të qenë aktive në paraqitjen e padisë për zgjidhjen e martesës përpara gjykatës së rrethit gjyqësor. Sipas gjykatave, marrë në tërësi të shifrave të monitorimit dhe viteve të përfshira kjo shkon nga më e ulëta 53% në më të lartën 70%.
- Ndonëse situata e vendimeve të pushimit në çështjet me objekt zgjidhje martese paraqitet heterogjene në krahasimin e bërë nga njëra gjykatë në tjetrën, vihet re se tendenca është që ende këto lloj vendimesh janë të konsiderueshme në sasi. Vendimet e pushimit shkojnë nga 15%-25% për Tiranë, Vlorën e Shkodrën. Këtu bën përjashtim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ku përqindjet e çështjeve të pushuara janë të ulëta.
- Ndër çështjet e zgjidhjes së martesës që përfundojnë me vendime pushimi, rastet ku paditëse është bashkëshortja, zënë një përqindje shumë më të lartë se sa proceset e iniciuara nga bashkëshortët. Në rreth 60% të çështjeve të pushuara në GjRrGj Tiranë, me objekt zgjidhje martese, paditëse ka qenë gruaja si bashkëshorte; për Durrësin kjo gjendje, sipas viteve të përfshira në monitorim shkon rreth 67-75%; Vlora numëron rreth 74% të çështjeve. E njëjtë është gjendja edhe në Shkodër.

Ka një tendencë në rritje të zgjidhjes së martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve bazuar në nenin 125 të KF i cili është neni që parashikon këtë mënyrë zgjidhjeje. Për Tiranë këto raste të kërkesave shkojnë nga 7% në 11%; për Shkodrën shifra shkon përafërsisht deri në 16% të rasteve të vitit 2011 dhe 19% në vitin 2012. Këtu nuk janë zbritur vendimet e pushimit. Për Vlorën zgjidhjet me pëlqim shkojnë në rreth 4%. Për Durrësin nga 9-10%. Marrëveshja e paraqitur në këtë rast, nuk mund të jetë e pranueshme nëse në të ka diferencime dhe pabarazi apo barazi thjesht formale e 'sa për sy e faqe' e cila në fakt çon në pabarazi reale. Për këtë kërkohet vigjilencë dhe profesionalizëm nga ana e gjykatës. Kodi i Familjes parashikon të drejtën që ka gjykata për të refuzuar zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok në se konstaton se marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve ose të njërit prej bashkëshortëve. Nga monitorimi del se nuk ka vendime të tilla ose vendime që bëjnë një analizë të tillë të thelluar.

- Ndërprerje të jetës së përbashkët si shkak për zgjidhjen e martesës sipas nenit 129 të KF paraqitet në numër të kufizuar rastesh.
- Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort mbetet mënyra më 'e përdorshme' për zgjidhje e martesës. Ndër shkaqet pasqyruara në vendimet gjyqësore janë ato që lidhen me stereotipitë gjinore të ngulitura dhe që ende janë pjesë e mentaliteteve diskriminuese. Disa nga shkaqet e evidentuara për zgjidhjen e martesës dhe stereotipat gjinore të evidentuara në vendimet gjyqësore rendisim: keqtrajtimin dhe dhunën me bazë gjinore në familje si shkak determinant në zgjidhjen e martesës; stereotipa diskriminuese në lidhje me të drejtat, detyrimet bashkëshortore në familje dhe marrëdhëniet familjare; stereotipa diskriminuese në lidhje me rolin e gruas në familje; stereotipa diskriminuese në lidhje me të drejtat ekonomike të bashkëshortëve, administrimin e pasurisë dhe të ardhurave, mënyrën e shpenzimeve financiare në familje dhe vendimmarrjen në lidhje me to; refuzimi i përmbushjes së detyrimeve në familje ndaj bashkëshortit/es dhe fëmijëve si dhe i ashtuquajtura fenomeni 'ludomania' që duket se po bëhet shqetësues në realitetin familjar shqiptar.

Gjetjet mbi pasojat e vendimeve të zgjidhjes së martesës kundrejt bashkëshortëve dhe ushtrimit

të përgjegjësishë prindërore përfshijnë:

- *Nëna është prindi që i lihen më së shumti fëmijët për përkujdesje pas zgjidhjes së martesës. Si e tillë ajo është ushtruesja kryesore e përgjegjësishë prindërore. Për gjykatën e Tiranës, këtë e hasim në 87-88% të vendimeve të monitoruara për vitin 2011-2012; për GjRrGj Durrës në 90% të rasteve për vitin 2011 dhe në 82% të rasteve për 2012. Po kështu ndodh edhe për Vlorën e Shkodrën.*
- *Nuk ka një konkluzion kategorik për të gjitha gjykatat lidhur me faktin nëse ndër çiftet që zgjidhin martesën dominojnë çiftet me fëmijë. Kjo qëndron për Tiranë [60%], Vlorën [nga 56%-64%] e Shkodrën [70%] por jo për Durrësin.*
- *Duke monitoruar respektimin e disa standardeve nga gjykatat e rretheve gjyqësore, kemi vënë re se gjykatat e monitoruara gjithnjë e më shumë tregojnë vëmendje dhe kujdes për përfshirjen e psikologut në proceset me të mitur me qëllim kuptimin më të mirë dhe përcaktimin e drejtë të planeve të prindërimit pas zgjidhjes së martesës.*
- **Është tipologji e vendimeve gjyqësore që në arsyetimin e vendimit lidhur me prindin që ushtron kryesisht përgjegjësinë prindërore gjykata ndalet tek figura e nënës të cilën e merr gjerësisht në analizë.** *Gjykata nuk bën të njëjtën analizë për atin të cilit nuk i lihet fëmija për të treguar se përse nëna është më e përshtatshme mbi bazën e një analize të thellë. Këtë analizë e kemi përqendruar kryesisht në GjRrGj Tiranë.*
- *Bashkëshorti është subjekti që më së shumti është ‘në mungesë’ në proceset me objekt zgjidhje martese.*
- *Edhe kur gjatë procesit të zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të ushtrimit të përgjegjësishë ndaj fëmijës ati i fëmijës është në mungesë, gjykata kujdeset për marrëdhëniet e kontaktet e fëmijës me atin. Në këto raste ajo që kemi konstatuar është se, ndonëse në mungesë të babait të fëmijëve, gjykata vendos duke i dhënë të drejtën e takimit dhe të drejtën për të marrë fëmijën me pushime babait, pa bërë asnjë analizë rreth tij, figurës së tij, etj. Janë kryesisht rastet kur edhe psikologu/punonjësi social nuk ka mundur të kontaktojë me babanë e fëmijëve sepse ai është në emigracion, nuk ka një adresë të saktë dhe nuk komunikon me familjen. Në fakt, vendime të tilla me të njëjtin format në rregullimet mbi ushtrimin e të drejtës së mbajtjes së kontakteve me fëmijën me vendimet kur prindi është prezent mund të vënë në dyshim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe veç kësaj mund të mbeten thuajse të pazbatueshme.*
- *Dispozitat më pak të kërkuara dhe zbatuara janë ato që kanë efekt mbi të drejtat e grave si bashkëshorte dhe që efektojnë pozitën e tyre ekonomike pas zgjidhjes së martesës. Fjala për nenin 139 KF mbi ‘Marrjen e masave të përkohshme’; nenet 192 dhe 199 të KF të cilët përmbajnë rregullime lidhur me ‘detyrimin për ushqim ndërmjet bashkëshortëve’; neni 153 i KF që përmban parashikime lidhur me të drejtën e përdorimit të banesës familjare; neni 147 i KF që parashikon detyrimin për kontribut kompensues, etj.*

Gjetjet nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore.

Çështjet pasurore janë shumë sensitive sa edhe të rëndësishme për cilësinë e jetës familjare. Kemi vënë re se edhe në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje ku subjekt sipas Ligjit të përkatës të dhunës në marrëdhëniet familjare [2006 ndryshuar] janë edhe ish bashkëshortët, ka rezultuar se një nga faktorët e prezencës së formave të ndryshme të dhunës lidhet me pasurinë

bashkëshortore dhe tendenca e ish bashkëshortëve për ta gëzuar atë realisht në natyrë duke iu mohuar grave çdo të drejt pasurore.

- *Gratë janë më aktive në paraqitjen e padive për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore. Rezulton se për periudhën objekt monitorimi nga 1 janar 2011 deri në maj 2012 për GjRrGj Tiranë ka rezultuar se në 69% të rasteve kërkesa përpara gjykatës për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore është paraqitur nga gratë. Bashkëshortët duket se janë më pak aktivë se sa bashkëshortet në paditë e pjesëtimin të pasurisë bashkëshortore sepse ata gëzojnë de facto pasurinë dhe nuk kanë 'interes' nga pjesëtimi gjyqësish.*
- *Shumica e vendimeve të pjesëtimin të pasurisë ku paditëse janë gratë, pushohen. Monitorimi për GjRrGj Tiranë na e jep këtë të dhënë për mbi 70% të tyre. Për GjRrGj Durrës në 35% të rasteve në total çështja pushohet dhe në të gjitha këto raste pra 100% paditëse është ish bashkëshortja. Ndër shkaqet janë vështirësitë e aksesit në gjykatë dhe të sigurimit të mbrojtjes adekuate.*
- *Nga vendimet gjyqësore të monitoruara në GjRrGj Tiranë, vihet re se gratë janë përfitueset kryesore të kthimit në natyrë të pasurisë bashkëshortore.*

Gjetje kryesore nga monitorimi i vendimeve gjyqësore dhe praktikës së QNL-së për çështjet me objekt lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Në këtë aspekt, gjetjet kryesore i referohen GjRrGj Tiranë.

NUMRI I VENDIMEVE TË MONITORUARA ME OBJEKT UM/UMM SIPAS GJYKATAVE DHE VITEVE				
Gjykatat	Tiranë	Durrës	Vlorë	Shkodër
2011	182	154	27	52
2012	239	78	54	31

Nuk ka koherencë dhe transparencë në hedhjen e të dhënave dhe vendimeve lidhur me UM/UMM dhe duket, nga sistemi sikur ka një numër më i ulët i kërkesave për UM/UMM. Krahasimi i numrit të kërkesave dhe vendimeve ndër vite tregon se rastet e denoncimit të dhunës në familje janë rritur.

- *Gratë janë më të dhunuarat në familje: Kështu nga 89% në 92% të rasteve nga vendimet e monitoruara për vitin 2011-2012 në GjRrGj Tiranë, kërkesa për UMM/UM është paraqitur nga gratë. Nuk mungojnë rastet e padive të paraqitura nga burrat. Për GjRrGj Durrës për gjithë periudhën shifra shkon në 91.5% në 87% të rasteve kërkesa për UMM/UM është paraqitur nga gratë. Vlora rezulton me 100% të vendimeve për 2011 në 94% për 2012.*
- *Fëmijët janë subjekte për të cilët kërkohet mbrojtje nga dhuna. Për vitin 2011, në GjRrGj Tiranë, në 36.5% të rasteve është kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët. Për 2012 kjo shifër shkon në 30.5%. Për Durrësin për vitin 2011, në 13% të rasteve është kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët dhe kjo shifër shkon në 19% për vitin 2012. rastet nuk mungojnë as në Shkodër. Janë 4 vendime ku fëmijët rezultojnë kërkues së bashku me nënën e tyre.*
- *Ende janë të larta rastet e vendimeve të pushimit për UM/UMM në përgjithësi dhe të atyre ku gratë janë paditëse në veçanti. Për Tiranën kjo shkon nga 91%-92% sipas viteve. Për GjRrGj Durrës, në rreth 84% të vendimeve të pushimit urdhri është kërkuar nga gratë.*
- *Marrëdhënia midis dhunuesit/viktimës shënon në nivel më të lartë dhunën ndërmjet bashkëshortëve dhe ish bashkëshortëve.*

NUMRI I VENDIMEVE TË MONITORUARA ME OBJEKT NENI 130/A TË KODIT PENAL SIPAS GJYKATAVE DHE VITEVE			
Gjykatat	Tiranë	Durrës	Shkodër
2012	26	7	0

Gjetje paraprake nga monitorimi i vendimeve gjyqësore penale: çështjet me objekt zbatimin e nenit 130/a,” Dhuna në familje” të KP, të ndryshuar në vitin 2012 dhe 2013.

Lidhur me praktikën e GjRrGj Tiranë, kemi konstatuar: për këto çështje ka një numër të madh vendimesh pushimi [65%]; të gjithë të dënuarit për kryerjen e veprës penale të dhunës në familje janë meshkuj; nga analiza e vendimeve ka rezultuar se gjykata ka dhënë vendimin e pushimit për 17 raste nga totali prej 26 dhe këto vendime pushimi janë dhënë në zbatim të ligjit nr.107/2012 “Për dhënie amnistie”. Lidhur me masën dhe llojin e dënimit vëmë re se: Ndër 9 të dënuar, gjykata penale në 7 raste ka dhënë dënim me burg, duke aplikuar nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale⁴ dhe në 2 raste gjykata ka vendosur dënimin me kohë prove. Në lidhje me marrëdhënien midis dhunuesit dhe viktimës ka rezultuar se në 7 raste dhuna ka ndodhur midis bashkëshortëve, në një rast në marrëdhëniet fëmijë/prind dhe në një rast në marrëdhënie të tjera.

Gjetjet nga monitorimi i zbatimit të Nenit 320 të Kodit Penal “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”⁵ dhe Nenit 321 të Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, i ndryshuar⁶. Rasti i GjRrGj Tiranë.

Duke qenë se objekt i monitorimit janë edhe disa vepra penale që lidhen me elemente gjinore u ndalëm në disa prej neneve të Kodit Penal që lidhen e respektimin e vendimeve të gjykatës. Për këto lloj veprash, të dënuarit për kryerjen e këtyre veprave janë më së shumti meshkujt. 92% për 2011 dhe 94% për 2012. Sa i përket llojit dhe masës së dënimit vihet re se dënimet me burg [18% të totalit të rasteve për të dy vitet] përbëjnë një numër të ulët të rasteve krahasuar me llojet e tjera të dënimit. Rezulton se kemi një rritje të rasteve, ku marrëdhënia midis të dënuarit dhe viktimës është marrëdhënie bashkëshortore [12 vendime për gjithë periudhën ose 43 %]. Në të njëjtën vlerë qëndron edhe marrëdhënia mes ish bashkëshortëve [12 raste për gjithë periudhën ose 43%] dhe mandej midis ish bashkëjetuesve [2 raste për të gjithë periudhën ose 14%].

Gjetje nga monitorimi i vendimeve penale lidhur me zbatimin e nenit 113 i K.P “Prostitucioni” ndryshuar.

Sipas kodit Penal, në nenin 113 (Shtuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012) “ushtrimi i

4 Neni 406 i K.P.P (Ndryshuar pika “1” me ligjin 8813, datë 13.6.2002)(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.145/2013, datë 2.5.2013, neni 2). Vendimi: 1. Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën. Dënimi me burgim të përjetshëm zëvendësohet me tridhjetë e pesë vjet burgim. 2. Kur ka kërkesë, gjykata vendos edhe për padinë civile. 3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëjnë ankim prokurori dhe i pandehuri. 4. Respektohet për aq sa janë të pajtueshme dispozitat e kreut III të këtij titulli.

5 Neni 320: Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës: “Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.”

6 Neni 321 (Shtuar paragrafi me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 44. Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës: “Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet e lindura nga dënimet plotësuese të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet.”

prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.” Nga monitorimi dalin këto gjetje kryesore: për ‘prostitucion’ dënohen kryesisht ose vetëm gratë; lloji dhe masa e dënimit e aplikueshme: nga 47% në 38% të rasteve kemi dënimin me burg dhe nga 53% në 62% me gjobë. Ka rezultuar nga monitorimi i vendimeve penale në GjRrGj Tiranë se për gratë e dënuara për prostitucion ka një politike dënimi më të ashpër, që do të thotë se ka më shumë gra të dënuara me burg dhe vetëm në një numër prej 7 rastesh për gjithë periudhën dënimi është dhënë me kohë prove.

- ❑ Mosha e të dënuarave për prostitucion për GjRrGj Tiranë shkon: 10% moshë e mitur; 20 % midis moshës 18-20 vjeç; 43.3% midis 21-30 vjeç.
- ❑ Arsimi i të dënuarave dhe vendbanimi: mbi 63% nga pa arsim ose deri në arsim 8 vjeçar. Rreth 13 % me arsim të mesëm. Për 23% nuk ka të dhëna lidhur me arsimin. Në 40 % të rasteve, të dënuarat janë me arsim 8 vjeçar, të ndjekur në 13.3 % të rasteve nga të dënuarat me arsim të mesëm dhe pa arsim. Edhe këto të dhëna i referohen monitorimit për GjRrGj Tiranë. Të dhëna lidhur me vendlindjen rezultojnë se në 83.3% të vendimeve vendlindja e raportuar është qyteti.
- ❑ Raporti, në vijim, ndalet në analizën e një rasti konkret dhe opinioneve juridike e kontributit të QNL mbi antikushitetshmërinë e nenit 113 të KP siç është rasti i B.Q. Menduam se do të ishte me vlerë për lexuesin jo vetëm të shihet një profil krejt të veçantë që ka kjo qendër, por edhe interpretimet e niveleve bashkëkohore më të larta në lëmin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut që kjo qendër ia ka siguruar vetes falë ekspertizës së lartë që zotëron.

Pjesë e raportit janë edhe gjetjet nga monitorimi i vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Ende ky institucion përdoret në mënyrë të kufizuar dhe veç kësaj duket se njohuritë për kuptimin diskriminimit dhe terrenet e mbrojtura është i kufizuara ose i gabuar apo pretenduesit nuk kanë njohurit të sakta e të plota. Monitorimi i KMD u realizua përmes raporteve vjetore të nxjerra nga ky institucion ne website-in zyrtar. Për vitin 2011 janë paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi 3 ankesa me pretendim për diskriminim për shkak të gjinisë. Në 2 prej tyre nuk është konstatuar diskriminim për shkak të gjinisë, ndërsa tjetra nuk është pranuar sepse nuk plotësonte kërkesat e ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për vitin 2012 janë paraqitur 2 ankesa me pretendim për diskriminim për shkak të gjinisë, nga të cilat, një ankese është pushuar për pamundësi të sigurimit të provave ndërsa tjetra është ende në proces shqyrtimi. Ndonëse në raportin e këtij institucioni thuhet se edhe në ankesa të tjera të shqyrtuara ka pasur elemente të diskriminimit gjinor, verifikimi i bërë nga stafi i QNL nuk gjeti diçka të tillë.

Gjetjet nga monitorimi i institucionit të Avokatit të Popullit: Nga hulumtimi bërë në faqen elektronike zyrtare të këtij institucioni dhe raportin vjetor për vitin 2011 u vu re se raporti nuk hapet/aksesoret. QNL nuk arriti të konkludojë lidhur me ankesat me përmbajtje diskriminuese. Për vitin 2012 nga verifikimet e bëra raportit të këtij institucioni, nuk u gjetën ankesa që të përmbajnë diskriminim për shkak të gjinisë.

v. Përmbledhje e përfundimeve dhe rekomandimeve

Nisur nga gjetjet e monitorimit përfundimet dhe rekomandimet kryesore i grupojmë në katër drejtime: të lidhura me kuadrin ligjor; me nxitjen e aktiviteteve me efekt ndërgjegjësues dhe trajnues; në zgjerimin e studimeve dhe publikimeve në fushën e barazisë gjinore; rekomandime të lidhura me përmirësimin e shërbimit që i ofrohen publikut me qëllim aksesin në institucione dhe realizimin e të drejtave të tyre.

Duhet të pranojmë se këto rekomandime nuk janë të parat në llojin e vet. Studime dhe monitorime të mëparshme kanë paraqitur sete rekomandimesh me vlerë sa i përket barazisë dhe mosdiskriminimit në çështjet familjare e martesore. Bërja e një përmbledhjeje të tyre dhe vendosja në një listë prioritare e rekomandimeve të papërbushura, mund të ishte një sugjerim me vend sikurse monitorimi i përfshirjes së tyre në dokumentet politike.

1. Lidhur me përmirësimin e institucioneve, të kuadrin ligjor dhe zbatimin e normave në fuqi

Monitorimi evidentoi se reforma ligjore ka qenë një proces dinamik. Kjo reformë nuk është shoqëruar me pasqyrim adekuat të standardeve ndërkombëtare të ratifikuara në vendimet gjyqësore. Disa nene të Kodit të Familjes ende kanë nevojë për pastrim nga ambiguiteti me qëllim që pas neutralitetit të tyre të mos fshihet pabarazia, për shembull çështja e mbiemrit të fëmijës. Disa nene duhet të mos kenë karakter deklarativ por të shoqërohen me efekte konkrete, rasti i masave emergjente.

Ende mbetet proces i vazhdueshme për qasja e legjislacionit me standardet ndërkombëtare siç është Konventa e Këshillit të Evropës mbi dhunën në familje, e njohur si Konventa e Stambollit e ratifikuar nga vendi ynë, etj. Siç edhe nënvizohet në Progres Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2013, ende ka probleme të mosnjohjes me jurisprudencën e GjEDNj dhe moszbatim të standardeve lidhur me të drejtat pronësore, procesin e rregullt, etj.

Në çështjet familjare një rol të veçantë ka psikologu. Rregullimet në KF duhet të shoqërohen me një rol adekuat në vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe me akte nënligjore lidhur me kriteret, kushtet, efektet financiare, etj elementë të detyrueshëm për psikologun e çështjeve me të mitur. Mbetet me rëndësi formalizimi i rolit të psikologut. Sugjerohet mundësia e analizës së kostove të psikologut dhe e krahasimit të tyre kostot, në rast se psikologu përfshihet në stafin administrativ të gjykatës duke u financuar nga shteti si një nëpunës i këtij. Po kështu, mbetet të merret në konsideratë mundësia e përjashtimit nga pagesat e psikologut kur prindërit janë të papunë ose një pagesë e përshkallëzuar në proporcion me nivelin e të ardhurave. Ka lindur nevoja e përcaktimit më të mirë i detyrave të psikologëve dhe punonjësve socialë pranë bashkive, me qëllim që të ofrojnë ekspertizën në çështjet gjyqësore kur palët nuk kanë aftësi paguese.

Ndërkohë, sa kohë që rezultatet tregojnë pabarazi, kjo duhet marrë si nxitje për reforma ligjore e politikash në vijimësi. Shpesh herë në ligjet neutrale duket se fshihen pasoja diskriminuese nga këndvështrimi gjinor. Në këtë drejtim mund të veçojmë aspektet ligjore lidhur me: probleme të pasurisë bashkëshortore gjatë martesës dhe në mbarim të saj; rregullime më të plota lidhur me vlerësimin e punës së papaguar; interesin me të lartë të fëmijës dhe përgjegjësitë prindërore; kontributin kompensues, detyrimin për ushqim, etj. Nisur nga vështirësitë që ka prindi që i lihet fëmija në përkuqdesje për të

lëvizur lirisht, të parashikohet mundësia e lejimit të prindit kujdestar për të lëvizur me fëmijën jashtë vendit vetëm duke bërë njoftimin e prindit tjetër dhe kjo të parashikohet si pjesë e planit të prindërimit në vendimet gjyqësore. Të shikohet mundësia e marrjes së masave të përkohshme me iniciative të gjykatës kur kjo vlerësohet në interesin e fëmijës gjatë proceseve të zgjidhjes së martesës.

Ndonëse ndryshimet në Kodin Penal konsiderohen si hapa pozitive përpara, mekanizmi referues kundër dhunës në familje ka nevojë për konsolidim dhe koordinim më të mirë. Ndër sugjerimet e paraqitura gjatë tryezave është edhe mundësia për ndryshimin e legjislacionit të dhunës në familje duke i lenë kompetence policisë që të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, ndërkohë që verifikimit ta bëjë gjykata. Gjithashtu, të parashikohet nga ana procedurale, qoftë edhe duke u parashikuar në diapozitivin e vendimit, mundësia që të njoftohen viktimat e dhunës në rastet e lirimit të parakohshëm nga institucioni ku dhunuesit vuajnë dënimin me heqje të lirisë. Organizimi më i mirë pranë gjykatave i listave të gjyqtarëve të gatshëm që do të gjykojnë urdhrat e mbrojtjes dhe i shortit të posaçëm, me qëllim që të mos ketë vonesa.

Ratifikimi i një numri të madh konventash nuk e ezauron plotësisht problemin sepse ende zbatueshmëria e konventave nuk është e duhura dhe referimi në to i limituar, kjo edhe për efekt të njohurive të limituara lidhur me to por edhe sepse vetëzbatueshmëria e tyre nuk është e mundur për shkak se mund të kërkohet dalja e një ligji të veçantë ose kjo përdoret si pretekst për moszbatimin e tyre.

2. Lidhur me ndërgjegjësimin dhe trajnimin

Sa kohë të drejtat gjenden në ligj, por këto ligje nuk njihen siç duhet, apo parcela me rëndësi të ligjeve qëndrojnë inaktive, atëherë është e njëjta sikur të mos kishte ligje. Puna me gratë për të njohur të drejtat e tyre duhet të jetë e vazhdueshme jo vetëm përmes aktiviteteve të OJF por edhe këshillimit bërë prej institucioneve siç janë noterët, avokatët, zyrtarë të ZRPP, pse jo edhe gjykatës brenda diskrecionit ligjor, etj.

OJF-të duke qenë se janë në ndërveprim dhe kanë njohje të drejtpërdrejtë me problemet sipas diversiteteve lokale, duhet të shpërndajnë informacion mbi të drejtat e grave në martesë e pas zgjidhjes së martesës, mbi fëmijët e pasurinë etj. Paralel nuk duhet neglizhuar ndërgjegjësimi i meshkujve me parimet e barazisë dhe mos diskriminimit.

Përdorimi i medias dhe mjeteve të tjera të informacionit, përgatitja e emisioneve televizive do të ishte efektive.

Trajnimi në vazhdimësi i profesionisteve ndërtuar mbi bazën e analizës së vendimeve të dhëna krahasuar me përvojën më të mirë për respektimin e standardeve të barazisë gjinore është një kërkesë e vazhdueshme.

- Të organizohen më shumë aktivitete të karakterit të seminareve ku punonjësit meshkuj, femrat shtëpiake të papuna, etj, të jenë pjesëmarrës.

3. Aksesi në informacion dhe shërbime përfshirë ndihmën dhe këshillimin ligjor

Kjo çështje duhet adresuar me shumë kujdes sepse ndihma ligjore e munguar apo e pa mbuluar financiarisht bën që gratë të tërhiqen nga proceset. Garantimi i ndihmës ligjore dhe financiare për viktimat duhet të mbështetet në një bazë ligjore të fortë ku kjo çështje të konsiderohet si prioritet. Të rriten mundësitë për zbatimin efektiv të ligjit "Për ndihmën Juridike".

- Të krijohet një regjistër kombëtar i adresave dhe të shihet mundësia e një njësie të posaçme në postën shqiptare për çështjet gjyqësore. Rregullimi i sistemit të adresave, me qëllim njoftimin e

palëve, do të ulte numrin e rasteve të pushimit të çështjes.

Te njihen nga organet kompetente shtetërore dhe te pajiset gjykata me bazën e të dhënave të qendrave të strehimit dhe rehabilitimit të viktimave dhe të dhunuesve si dhe shërbimet e tjera.

4. Studime e monitorime si mjet reflektimi për gjendjen dhe nevojë për përmirësim

Të shtohen dhe të përmirësohen studimet në këtë fushë, për të gjykuar më mirë mbi standardet barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në çështjet familjare dhe më gjerë. Veç OJF-ve kjo mbetet një detyrë me rëndësi për studiuesit, fakultetet, Shkollën e Magjistraturës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, etj.

I

Referimi i standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare lidhur me barazinë gjinore dhe mos diskriminimin në vendimet e monitoruara

1.1. Shkurt mbi standardet ligjore objekt i monitorimit

Duke qenë se diskriminimi në përgjithësi dhe ai me bazë gjinore në veçanti është një fenomen endemik, global dhe rajonal që cenon thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, vëmendja e kujdesi për t'i vendosur standarde në instrumentet ndërkombëtare ka qenë e vazhdueshme. Në këtë drejtim vendi ynë ka bërë një sërë përparimesh në ratifikimin e tyre. Si të tilla instrumente me rëndësi të veçantë në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit përmendim Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW⁷); KEDNJ e veçanërisht nenin 14 të kësaj Konvente dhe Protokollin 12 të saj, Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), etj. Pas ratifikimit, çdo konventë bëhet pjesë e legjislacionit të brendshëm. Kuvendi ka ratifikuar së fundmi edhe Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”⁸. Pikërisht këto Konventa dhe instrumente të tjerë të cituar në vendimet e gjykatave që u monitoruan u bënë pjesë e këtij dokumenti.

Konventa CEDAW

Në paragrafin 16 të Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë, ky Komitet është ndalur në rëndësinë që ka bërja sa me të dukshme të Konventës dhe Protokollit Opsional të saj. Sipas këtij dokumenti: “... Veçanërisht, Komiteti mbetet i shqetësuar që dispozitat e Konventës *nuk janë përmendur në procese gjyqësore*, gjë që tregon se ka njohuri të pamjaftueshme në shoqëri në përgjithësi dhe në vetë gratë, tek të gjitha degët e qeverisjes, duke përfshirë gjyqësorin, për të drejtat e grave sipas Konventës dhe Protokollit të saj Opsional, konceptin e barazisë lëndore (de facto) të grave dhe burrave dhe rekomandimeve të përgjithshme të Komitetit. Për këtë qëllim në paragrafin 17 të Vërejtjeve përmbyllëse Komiteti rekomandon që Shteti palë të zgjerojë sistematikisht njohuritë dhe konceptin e Konventës dhe protokollit të saj Opsional.

Gjithashtu, po në këtë dokument, rishtohet⁹ çështja e vetzbatueshmërisë së Konventës CEDAW. Komiteti kërkon në mënyrë të veçantë që vendi ynë si shtet palë t'i paraqesë Komitetit në raportin periodik të radhës informacion në lidhje me çështjet gjyqësore që Konventa, ose dispozitat e saj, janë kualifikuar si të vetë-zbatueshme, dhe në këtë mënyrë janë zbatuar drejtpërdrejt.

Sipas konventës CEDAW shtetet duhet ti njohin grave të drejta të barabarta me burrat dhe të sigurojnë mbrojtje ligjore për të drejtat e grave, mbi bazën e barazisë me burrat. Shtetet duhet të

7 Konventa e CEDAW e 1979 është ratifikuar nga 185 shtete. **Shqipëria e ratifikoi CEDAW më 1993** (Ligji 1769/9.11.1993)

8 LIGJ Nr. 104/2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

9 (A/58/38(Supp), par. 59)

sigurojnë, nëpërmjet gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të grave kundër çdo veprimi diskriminues [neni 2/c i CEDAW]. Është detyrë e gjykatave kombëtare që të bëjnë një trajtim të barabartë të grave me burrat në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore [neni 15/2 CEDAW].

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

Ky instrument me rëndësi të veçantë, parashikon se parimi barazisë gjinore është një nga parimet themelore të ligjit të të drejtave të njeriut. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vazhdimisht është shprehur se “barazia e sekseve është një nga qëllimet madhore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës”, dhe kohët e fundit e ka deklaruar barazinë gjinore si një nga parimet themelore, thelbësore të Konventës. Neni 14 i KEDNJ-së është dispozita bazë kundër diskriminimit.

Në të përcaktohet se:

Gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Konventë, do të sigurohet pa diskriminim, për çdo lloj arsyeje si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, të shoqëruarit me statusin e pakicës kombëtare, pronës, lindjes, apo ndonjë status tjetër. (Neni 14 i KEDNJ-së – Ndalimi i Diskriminimit)

Protokolli 7 i KEDNJ dhe përkatësisht neni 5 i tij

Neni 5 i Protokollit Nr. 7 të KEDNJ-së¹⁰ përmend shprehimisht barazinë: Bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësish të karakterit të së drejtës private midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj. Ky nen nuk do t'i ndalojë Shtetet që të marrin masa të nevojshme në interesin e fëmijëve. (Neni 5 – Barazia midis bashkëshortëve)

Protokolli 12 i KEDNJ, përkatësisht neni 1 i tij

Mbrojtja nga diskriminimi sipas Nenit 14 të KEDNJ, u plotësua me Nenin 1 të Protokollit 12 të KEDNJ-së. Neni 1 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit:

1. Gëzimi i një të drejte të parashikuar me ligj do të sigurohet pa diskriminim për asnjë shkak të tillë si, seksi, raca, ngjyra, feja, mendimi politik apo ndonjë mendim tjetër, origjina kombëtare apo shoqërore, lidhja me një pakicë kombëtare, pronë, lindje apo ndonjë status tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga ndonjë autoritet publik për shkaqe të tilla si ato që përmenden në paragrafin 1.

Protokolli 12 e zgjeron gamën e zbatimit të Nenit 14, duke parashikuar **një zbatim krejtësisht të pavarur të parimit të mos-diskriminimit “për çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”**. Ky protokoll veçanërisht zgjeron gamën e mbrojtjes nga mos-diskriminimi për të përfshirë detyrimin negativ të palëve kontraktuese si edhe një detyrim pozitiv (për të marrë masa për mbrojtje nga diskriminimi, edhe kur diskriminimi ndodh midis palëve private). Ai qëndron pranë Nenit 14, pa e ndryshuar apo shfuqizuar atë. Megjithatë, sikurse Neni 14, ai nuk garanton mos-diskriminim në terma absolute. Përkundrazi, ai ndjek përqasjen e miratuar nga GjEDNJ-ja në juridiksionin e saj.

¹⁰ Hyrja në fuqi në Shqipëri: 1 janar 1997.

Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” [Ligji Nr. 104/2012]

Përkufizimi i dhunës në familje dhe llojeve të saj gjendet në disa instrumente ndërkombëtarë e ligje vendase. Së fundmi, Shqipëria ka ratifikuar një instrument shumë të rëndësishëm të Këshillit të Evropës, siç është Konventa “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. Duke e konsideruar dhunën në familje çështje të diskriminimit gjinor, Konventa në nenin 3/b nënvizon se me “dhunë në familje” nënkuptohen të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

Konsiderata të përgjithshme të GJEDNJ

“Nocioni i diskriminimit është interpretuar në mënyrë konsistente nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj ligjore, që ka të bëjë me Nenin 14 të Konventës. Gjithnjë e më shumë përpara kësaj gjykate shfaqen raste që kanë të bëjnë me diskriminimi përfshi edhe diskriminimin gjinor¹¹. Në veçanti, këto çështje e kanë bërë të qartë se jo çdo dallim apo ndryshim në trajtim përbën diskriminim. Sikundër ka konstatuar Gjykata, për shembull, në gjykimin e saj në çështjen e Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar: “një ndryshim në trajtim është diskriminues në rast se ‘ai nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm’, që do të thotë, në rast se ai nuk ndjek një ‘qëllim të ligjshëm’ apo kur nuk ka ‘një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet’” (gjykimi i 28 majit 1985, Seria A, Nr 94, para. 2). Kuptimi i termit “diskriminim” në Nenin 1 ka për qëllim të jetë identik me atë të Nenit 14 të Konventës.

Ligji “Mbi barazinë gjinore në shoqëri” [Ligji Nr.9970/28.7.2008]

Nga vet objekti i tij duket se ligji rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.

Duke qenë se jeta publike ka një impakt të drejtpërdrejtë në jetën familjare, si psh, mosdiskriminimi në marrëdhëniet e punës, mosdiskriminimi në arsim, trajnime, etj, me të drejtë themi se respektimi i këtyre parimeve në rekrutim etj sjell avantazhe ekonomike për gratë dhe automatikisht rritjen e të ardhurave të tyre dhe të autonomisë së administrimit të tyre sipas interesit të familjes dhe vetjak.

Një nen i rëndësishëm që bën qasje me vlerë të përgjegjësive familjare si kontribut, është neni 23 lidhur me ‘Vlerësimin e punës së papaguar’.

1. Puna e papaguar e femrave dhe e meshkujve vlerësohet kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, në rast kur ai/ajo:

- a) kujdeset për mirëqenien e familjes;
- b) kujdeset për fëmijët;

11 Për më shumë lidhur me vendimet që kanë të bëjnë me diskriminimi gjinor në jurisprudencën e GJEDNJ, shih në: <http://hudoc.echr.coe.int>.

- c) kujdeset për anëtarë të tjerë të familjes;
- ç) punon në bujqësi dhe ekonomi familjare.

2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përfitojnë nga shërbimet në komunitet, politikat e punës dhe të punësimit, si dhe të formimit profesional në bazë të legjislacionit në fuqi.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” [Ligji nr. 221/4.2.2010]

Nuk mungojnë rastet që diskriminimi është i lidhur me statusin marital. Askush nuk mund të diskriminohet në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Sipas nenit 7 nën titullin ‘Mbrojtja nga diskriminimi’, përbën diskriminim, çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Mbrojtja juridiko- civile dhe juridiko penale ndaj dhunës në familje

Në kontekstin e akteve normative, një vend të veçantë zë Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” [Ligji Nr.9669/18.12.2006, ndryshuar]. Sipas LDHF: “Dhuna në familje” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër me të cilin ka apo ka qenë në marrëdhënie familjare dhe që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social dhe ekonomik.

Ligji “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” [Nr.10 347/4.11.2010] përcakton se ‘dhunë ndaj fëmijëve është përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i formave të tjera të forcës, qoftë me kërcënim ose aktuale, kundër fëmijës a grupit të fëmijëve, e cila rezulton apo ka shumë të ngjarë që të rezultojë në dëmtim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim’. Dhuna ndaj fëmijëve në familje përbën vepër penale: Neni 124/b i Kodit Penal parashikon se: “Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.”. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore, nëse dënohet si autor ose bashkëpunëtor në një vepër penale ndaj fëmijës, humbet përgjegjësinë prindërore [neni 43/a i KP]

Kodi Penal i RSH ndryshuar, përkatësisht neni 130/a parashikon në mënyrë specifike dhunën në familje si vepër penale:

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Po këto vepra të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen me burgim nga 1 vit gjer në 5 vjet”.

1.2. Zbatimi/referimi i standardeve ndërkombëtare dhe jurisprudencës së GJEDNJ në vendimet gjyqësore të monitoruara

Analiza në vijim ndalet në vendimet e monitoruara për GjRrGj Tiranë. Konstatohet se për vitin 2011, nga 618 vendime gjyqësore në GjRrGj Tiranë, gjyqtarët i janë referuar standardeve ndërkombëtare në këtë mënyrë:

- Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve (OKB) në 64 raste: Sipas monitorimit, ndër nenet më të cituara në vendimet gjyqësore është: Neni 3, cituar në 59 vendime; Neni 3/1 cituar në 2 vendime; neni 3/1 së bashku me nenin 1, cituar në 2 vendime. Në 1 vendim, nuk është përmendur neni por vetëm është cituar KDF dhe bashkë me të edhe Deklarata për të Drejtat e Fëmijëve. Në një rast vetëm citohet si “Konventa e New York –ut “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të të miturve”.
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është cituar në 12 vendime: Ndër nenet e cituara renditet neni 8 [gjithsej në 9 vendime] dhe neni 8/1 [gjithsej në 3 vendime].
- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në 29 vendime: Në të gjitha këto vendime është cituar neni 53 dhe 54 i Kushtetutës. Herë më vete dhe herë të kombinuar me njëri tjetrin ose paragrafë të ndryshëm të tyre.
- Vendime të gjykatës Kushtetuese gjermane janë cituar në 6 raste: Për të gjitha vendimet objekti është zgjidhja e martesës. Referimi tek gjykata kushtetuese gjermane është bërë në lidhje me mbrojtjen e martesës dhe familjes nga shteti. Në 6 raste është referuar vendimi i Senatit të Parë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane, dt. 17 janar 1957- BverfGE 6¹².
- Nga çështjet e monitoruara, nuk ka rezultuar në asnjë rast referimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- Nga çështjet e monitoruara, nuk ka rezultuar në asnjë rast referimi i Konventës CEDAW apo vendimeve të Komitetit CEDAW
- Konventat e Hagës janë cituar në 3 raste. Ndonëse këto konventa nuk lidhen drejtpërdrejtë

12 Vendimi nr. 1022, 1181, 1472, 1540, 2662, 5271

me çështjet objekt monitorimi, vlerësuam përdorimin e tyre nga gjykata.¹³

Konstatohet se për vitin 2012, nga 474 vendime të monitoruara, gjyqtarët e GjRrGj Tiranë i janë referuar standardeve ndërkombëtare në këtë mënyrë:

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë referuar në 18 vendime: Edhe për këtë vit mbetemi kryesisht tek përmbajta e neneve 53 dhe 54 që lidhen me objektin e monitorimit¹⁴.
- Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjenden të cituara në 1 vendim. Bëhet fjalë për vendimin nr.4322/02.05.2012 ku gjykata vetëm e ka përmendur GJEDNJ dhe jo të jetë referuar një rast konkret [fq.15 e vendimit].
- Konventa CEDAW dhe jurisprudenca e Komitetit CEDAW nuk është cituar në asnjë vendim gjyqësor në asnjë rast.
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve (OKB) citohet në 57 vendime¹⁵.
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut citohet në 16 vendime: kështu sipas neneve kemi, neni 12, në 1 vendim; Neni 8, në 2 vendime; neni 8 dhe 12 së bashku, në 8 vendime; Neni 8, 8/1, 12- në 5 vendime.
- Konventa e Hagës është gjetur e cituar vetëm në 1 vendim. Fjala për Konventën e vitit 1961 “Mbi heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare te huaja”

Monitorimi nuk nxori të dhëna lidhur me referimin e akteve ndërkombëtare në vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, referuar tek vendimet sipas bazës ligjore objekt monitorimi, kemi vëmë re se në vendimet e monitoruara nuk përmenden fare akte të tilla si Konventa CEDAW apo Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” etj. Lidhur me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ndërsa nuk ka referime në standardet dhe jurisprudencën ndërkombëtare për periudhën e monitoruar, duket se në vendime të vitit 2013 po bëhet më shumë kujdes për të pasqyruar ekstrakte të Kushtetutës së RSH apo të instrumenteve ndërkombëtare.

Si përfundim, siç vihet re, në çështjet e monitoruara, ende zë pak vend referimi në standardet ndërkombëtare dhe jurisprudencës së GJEDNJ. Të njëjtën themi edhe për zbatimin e ligjeve të tilla si “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe “Për barazinë gjinore në shoqëri” ndonëse efekti i tyre është më evident në çështje të së drejtës publike.

13 Kështu ndër konventat e Hagës të cituara është ajo “Për Njoftimin dhe Dorëzimin Jashtë Shtetit të Dokumenteve Gjyqësore dhe Jashtëgjyqësore në Fushën Civile dhe Tregtare” të vitit 1965 dhe Konventës së Hagës 05.10.1961. Shih për vitin 2011: Vendimi 1794; Vendimin **3270, vendimi 10760**.

14 Për këtë periudhë monitorimi citimi i neneve të Kushtetutës është në këtë mënyrë: neni 53- në 6 vendime; Neni 53, 53/1- ne 5 vendime; Neni 53, 53/1, 54- ne 2 vendime; Neni 53, 54, 54/1 - ne 1 vendim; Neni 53, 54/1- ne 1 vendim; Neni 53/1- në 2 vendime; Ne 1 rast nuk është cituar neni.

15 Neni 12- ne 1 vendim; Neni 12,13- ne 4 vendime; Neni 12, 9/3- ne 1 vendim; Neni 3 - ne 28 vendime; Neni 3, 3/1- ne 1 vendim; Neni 3, 12- ne 3 vendime; Neni 3,12,13- ne 9 vendime; Neni 3/1- ne 2 vendime; Neni 3/1, 9/3- ne 2 vendime. Preambula e KDF dhe thjesht citim i DDF është bërë në 1 vendim; Preambula e KDF, neni 9/3 & thjesht citim i DDF është bërë në 1 vendim; Preambula e KDF, neni 5, 9/3 & thjesht citim i DDF- ne 1 vendim; Ne 1 rast është referuar si konventa e New York –ut “Për mbrojtjen dhe respektimin e te drejtave te te miturve” nuk ka cituar nen të veçantë.

II

Impakti gjinor në vendimet me objekt zgjidhje martesë dhe pasojat e tyre

Synimi i monitorimit të praktikës gjyqësore është evidentimi i aspekteve pozitive dhe mangësive lidhur me respektimin e standardeve të barazisë gjinore në momente kaq delikate siç është zgjidhja e martesës dhe pasojave që vijnë prej saj.

Nga mënyra se si qëndrojnë dispozitat e Kodit të Familjes vëmë re tri shtylla kryesore të parimit të barazisë:

- Barazinë e burrit dhe gruas si bashkëshortë: këtu barazia shtrihet si në marrëdhëniet personale ashtu edhe pasurore dhe përfshin të drejtat dhe detyrimet e barabarta që nga lidhja e martesës e deri në mbarimin e saj duke përfshirë marrëdhëniet në martesë dhe pasojat e zgjidhjes së martesës;
- Barazinë e burrit dhe gruas si prindër kundrejt fëmijëve të tyre. Pra, si prindër bashkëshortët kanë përgjegjësi, të drejta e detyrime të barabarta. Në ligj kjo barazi e prindërve kundrejt fëmijëve nuk kondicionohet vetëm nga martesë por thjesht nga të qenit prind;
- Barazinë e fëmijëve pavarësisht statusit marital të prindërve. Jo vetëm fëmijët e lindur jashtë martesë, por edhe për fëmijët e birësuar nuk ka asnjë diskriminim në dispozitat ligjore.

Për të bërë këtë analizë të çështjeve të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në çështjet me objekt zgjidhje martesë dhe pasojat e saj, jemi ndalur në vendime që kanë për objekt:

- Çështje që lidhen me legjitimimin aktiv e pasiv në paditë me këtë objekt dhe të mënyrave të përdorura për zgjidhjen e martesës;
- Pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore dhe ndarjen e pasurisë midis bashkëjetuesve;
- Çështje të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës;
- Detyrimin për ushqim dhe për mbajtje të fëmijës dhe bashkëshortit nevojtar;
- Kontributin kompensues, etj çështje me rëndësi.

NUMRI I VENDIMEVE TË MONITORUARA ME OBJEKT ZGJIDHJE MARTESE SIPAS GJYKATAVE DHE VITEVE				
Gjykatat	Tiranë	Durrës	Vlorë	Shkodër
2011	618	272	213	257
2012	474	151	82	79

Në rang vendi, statistikat tregojnë se ka një tendencë në rritje të numrit të çështjeve me objekt zgjidhje martesë¹⁶. Kjo tipologji vihet re edhe në gjykatat e monitoruara. Tabela paraqet kampionin që është analizuar nga ky studim sipas gjykatave.

¹⁶ Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 2010.

2.1. Disa konkluzione nga monitorimi i vendimeve me objekt zgjidhjen e martesës

Gruaja si bashkëshorte po merr gjithnjë e më shumë kurajën për të paraqitur ajo padinë për zgjidhjen e martesës përpara gjykatës.

Si konkluzion, dhënë në përqindje, gratë paraqiten si paditëse përpara GjRrGj të monitoruar në paditë me objekt zgjidhje martese në këto shifra/përqindje:

- GjRrGj Tiranë: nga 53% në vitin 2011 deri në 58% për periudhën e 2012, pra le të themi mesatarisht mbi 55% për gjithë periudhën e monitoruar.
- GjRrGj Durrës: nga 54% në vitin 2011 deri në 55.6% për periudhën e 2012. Mesatarisht edhe për këtë gjykatë 55% e padive për zgjidhje martese paraqiten prej grave si bashkëshorte;
- GjRrGj Vlorë: nga 54% në vitin 2011 deri në 66% për periudhën e 2012. Vëmë re një rritje evidente për 5 mujorin e vitit 2012, çka e bën mesatare e gjithë periudhës 60%.
- GjRrGj Shkodër: Për gjithë periudhën e monitorimit mesatarja e kërkueseve gra është 63% për vitin 2011 dhe 59% për vitin 2012 .

Viti	Vendime Të monitoruara	Paditëse-gra në nr dhe %	Paditës- burra në nr dhe %	Gjykata
2011	618	360 ose 58.3%	258 ose 41.7%	Tirana
01.01/31.05.2012	474	252 ose 53.1%	222 ose 46.8%	
2011	272	147 ose 54%	125 ose 46%	Durrës
01.01/31.05.2012	151	84 ose 55.6%	67 ose 44.4%	
2011	213	115 ose 54%	98 ose 46%	Vlorë
01.01/31.05.2012	82	53 ose 67%	26 ose 33%	
2011	257	160 ose 62.2%	55 ose 21.4%, të dy 42 ose 16.3%	Shkodër
01.01/31.05.2012	79	47 ose 59.4%	17 ose 21.5%, të dy 15 ose 18.9%	

Në vijim po paraqesim një analizë më të gjerë.


Nga monitorimi për GjRrGj Tiranë kemi: për vitin 2011 rezulton se në rastet me objekt zgjidhje martese [nga 618 vendime të monitoruara në total], gjykata, në 360 raste ose në 58.3% të rasteve të monitoruara është vënë në lëvizje nga bashkëshortja e cila është paraqitur me cilësinë e paditëses. Pjesa tjetër, konkretisht 41.7 % e këtyre çështjeve, është vënë në lëvizje nga bashkëshorti i cili ka marrë rolin e paditësit. Edhe për periudhën e monitoruar të vitit 2012, ndër 474 vendime, kërkesat për zgjidhje martese të paraqitura nga gratë si bashkëshorte ka zënë 53.1 % ose në 252 raste kundrejt 46.8% të paditësve burra si bashkëshortë. Pavarësisht se shtimi i këtyre padive dëshmon

tronditjen e martesës, ajo që vihet re është rritja e vetëdijes dhe e përpjekjeve të grave për tu trajtuar si të barabarta në familje dhe për të kërkuar vetë ato gjyqësisht zgjidhjen e martesës e cila de facto ka humbur kuptimin.

Për GjRrGj Durrës kemi: Gjatë vitit 2011 rezultoi një përqindje më e lartë e paditëseve gra. Kështu nga 272 vendime të monitoruara në total për këtë vit, 147 kërkesë padi janë paraqitur nga gratë si bashkëshorte që do të thotë se në 54% të rasteve janë gratë si paditëse kundrejt 46% rasteve ku paditës është burri si bashkëshort. Sa i përket periudhës 5 mujore të vitit 2012, janë monitoruar 151 vendime nga të cilat në 84 prej tyre kërkesë padia është paraqitur nga bashkëshortja ose në 55.6% të rasteve. Në 67 raste ose 44.4% të tyre kërkesa është bërë nga bashkëshorti.

Për GjRrGj Vlorë: për vitin 2011 janë monitoruar gjithsej 213 vendime për zgjidhjen martesës. Nga këto në 98 raste ishin paditës burrat si bashkëshortë, domethënë 46% e tyre dhe në 115 raste ishin paditëse gratë, ose e thënë ndryshe në 54% të tyre. Pra, gratë në një përqindje më të lartë. Për vitin 2012 janë monitoruar 82 vendime të zgjidhjes së martesave. Nga këto në 26 raste ishin paditës burrat, domethënë 33% dhe në 54 raste ishin paditëse gratë, domethënë 67%. Nga këto vetëm 3 raste ishin me marrëveshje midis palëve, domethënë 3.7%. Nga monitorimi në këtë gjykatë, në rastet e zgjidhjes së martesave, është evidentuar fakti që gjykata mendohej të siguronte barazinë e palëve në proces si dhe barazinë ndërmjet burrit dhe gruas. Në përgjithësi një nga shkaqet kryesore të zgjidhjes së martesave ishte fakti se bashkëshortët lidhnin martesë pa e njohur mirë njëri tjetrin, me mblesëri apo shkuesi. Ky fakt bënte që shumë shpejt martesë të shkatërrohej dhe palët të drejtoheshin gjykatës. Vendimet e gjykatës (në disa raste) dukeshin sikur ishin të njëjtë në interpretim e argumentim. Ndoshta kjo dhe për faktin e ngjashmërisë së rasteve të tilla të zgjidhjes së martesave. Monitorimet e proceseve kanë treguar se gjykata tregojë e kujdesshme në seancë në mënyrë që të mos diskriminonte asnjërin prej palëve duke iu dhënë të drejta të barabarta dhe mundësi të barabarta për të provuar faktet që ata pretendonin. Kjo gjë shihej dhe në aspektin tjetër të mosdiskriminimit të fëmijëve nga ndonjëri prej prindërve. Gjykata pasi dëgjonte ekspertin psikolog, duke vlerësuar të gjitha provat, si dhe përfundonte hetimin gjyqësor vendoste lënie e fëmijës për rritje dhe edukim pranë atij prindi që jo vetëm i siguronte kushte më të mira, por dhe pranë atij prindi i cili nuk do të shkelte të drejtat e fëmijëve në lidhje me takimet apo marrëdhëniet me prindin tjetër.

Për GjRrGj Shkodër: Në vitin 2011 nga 257 vendime në 160 prej tyre paditëse janë gra, 55 burra dhe 42 raste kërkesa për zgjidhje martesë është paraqitur nga të dy bashkëshortët sipas nenit 125 të kodit të Familjes. Në vitin 2012: nga 79 vendime në 47 prej tyre paditëse janë gra, në 17 raste



kjo padi është paraqitur nga bashkëshortët dhe në 15 raste me kërkesë nga të dy bashkëshortët.

Në shumicën e rasteve, zgjidhja e martesës ka ardhur si rrjedhim i vendosjes së UMM dhe UM, me kërkesën e viktimës (pra, grave si bashkëshorte).

Ndonëse situata e vendimeve të pushimit në çështjet me objekt zgjidhje martese paraqitet heterogjene nga njëra gjykatë në tjetrën, ende këto lloj vendimesh janë të konsiderueshme në sasi. Bën përjashtim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku ka një përqindje të ulët të çështjeve të pushuara.

Si konkluzion:

Rreth 25% ose ¼ e padive për zgjidhje martese në GjRrGj Tiranë përfundojnë me vendime pushimi. Në GjRrGj Durrës paditë me objekt zgjidhje martese pushohen në një numër shumë të pakët rastesh, nga 2% deri në 4.4% sipas periudhës së monitorimit. Rreth 15% e padive për 2011 dhe më pak se 4% për 2012 për zgjidhje martese në GjRrGj Vlorë përfundojnë me vendime pushimi. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër për vitin 2011, 38% e kërkesë padive për zgjidhje martese rezultojnë të pushuara ndërsa për vitin 2012 rezultojnë rreth 15% e tyre.

Për të parë se si përfundojnë proceset e zgjidhjes së martesës, kemi analizuar çështjet e pranuar dhe të pushuara me objekt zgjidhjen e martesës. Në këndvështrimin gjinor, kjo do të na ndihmojë për të parë konsekuencën e bashkëshortëve për të vazhduar apo pushuar një proces dhe mandej, për të analizuar shkaqet dhe motivet që e çojnë një çështje drejt shkaqeve ligjore të pushimit.

GjRrGj Tiranë: Rezulton se gjatë vitit 2011 vendimet e pushimit zënë 24 % të rasteve të monitoruara dhe për periudhën e monitoruar gjatë vitit 2012 ato zënë 28%. Pra, në total mund të themi se mbi ¼ padive që paraqiten në gjykatë përfundojnë me pushimin e çështjes.

Sipas dispozitave procedurale civile, duket se në këto vendime shkaqet e pushimit janë ligjore, pra pala paditëse tërhiqet nga kërkesa nëpërmjet deklarimit në seancë gjyqësore se heq dorë nga kërkesë padia ose megjithëse ka dijeni për datën dhe orën e gjykimit nuk paraqitet. Por, bazuar edhe në praktikën e ofrimit të shërbimit ligjor falas nga QNL, mendojmë se ka edhe faktorë të tjerë që ndikojnë. Të tillë janë paaftësia paguese për psikologun, pasaktësitë në lidhje me adresën e palës së paditur dhe problematika të ndryshme sociale me të cilat gratë përballen përfshi këtu edhe mundësinë e mbulimit të shpenzimeve të një avokati mbrojtës.

GjRrGj Durrës: Rezulton se gjatë vitit 2011 vendimet e pushimit zënë 4.4 % të rasteve dhe për vitin 2012 vendimet e pushimit zënë 2 % të rasteve. Pra, ka një kujdes dhe vendosmëri në zgjidhjen e martesës.

Rreth 15.5% e padive për 2011 dhe më pak se 4% për 2012 për zgjidhje martese në GjRrGj Vlorë përfundojnë me vendime pushimi. Për vitin 2011, në 171 raste nga 213 që është totali i vendimeve të monitoruara, është pranuar padia duke u vendosur zgjidhja e martesës, lënia për rritje dhe edukim fëmijëve që në më të shumtën e rasteve i liheshin nënës dhe detyrimi ushqimor i prindit tjetër, si dhe e drejta e takimit. Numri i padive të pranuar, rreth 80%, është shumë më i lartë se i padive të pushuara që shkon tek 15.5% për vitin 2011. Mbetja, rreth 4.5% përbëhet nga vendime që kthehen për të meta në padi, etj. Ndër shkaqet e pushimit rendisim këto të dhëna: në 33 raste është dhënë vendim pushimi, sepse paditësi nuk paraqitej në seancë gjyqësore dhe në bazë të

Kodit të Procedurës Civile, gjykata e pushonte çështjen¹⁷. Në 9 raste është kthyer padia me të meta, kryesisht për adresat e të paditurve që ishte detyrim i paditësit ti paraqiste [neni 154 të KPrC]. Duke qenë se paditësit nuk paraqesin adresa të sakta dhe duke mos u realizuar njoftimi kthehej padia me të meta deri sa të plotësoheshin të metat. Gjykata mund ta përsëriste disa herë procesin deri sa pala paditëse të gjente një adresë të saktë, por nuk mund ta zgjaste procesin pambarimisht duke vendosur përfundimisht kthimin e padisë si padi me të meta. Për vitin 2012, në 79 raste nga totali prej 82 vendime të monitoruara, është pranuar padia duke u vendosur zgjidhja e martesës, lënia për rritje dhe edukim fëmijëve që në më të shumtën e rasteve i liheshin nënës dhe detyrimi ushqimor i prindit tjetër si dhe e drejta e takimit. Në këtë vit numri i padive të pranuar është shumë më i lartë se ato të pushuara, rreth 96.3% dhe për rrjedhojë numri i padive të pushuara është shumë i vogël për këtë vit, rreth 3.7%. Në 3 raste është dhënë vendim pushimi, sepse paditësi nuk paraqitej në seancë gjyqësore dhe në bazë të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e pushonte çështjen. Arsyet e mosparaqitjes së paditësit në të dy vitet konsiderohen një lloj heqjeje dorë sepse mund të prezumohej që palët mund të ishin pajtuar jashtëgjyqësisht duke shmangur kështu zgjidhjen e martesës.

GjRrGj Shkodër: Rreth 38 % e padive për zgjidhje martese në GjRrGj Shkodër përfundojnë me vendime pushimi për vitin 2011. Për vitin 2012 kështu kanë përfunduar 15% e çështjeve.

Ndër çështjet e zgjidhjes së martesës që përfundojnë me vendime pushimi, rastet ku paditëse është bashkëshortja, zënë një përqindje shumë më të lartë se sa proceset e iniciuara nga bashkëshortët.

Në rreth 60% të çështjeve të pushuara në GjRrGj Tiranë, me objekt zgjidhje martese, paditëse ka qenë gruaja si bashkëshorte. Për Durrësin kjo shkon sipas viteve të përfshira në monitorim nga rreth 67-75% ndonëse siç e përmendëm për këtë gjykatë vendimet e pushimit janë të pakta në numër. Në rreth 74% të çështjeve të pushuara për zgjidhjen e martesës në GjRrGj Vlorë, paditëse ka qenë gruaja si bashkëshorte. Në GjRrGj Shkodër në rreth 75% të çështjeve të pushuara paditëse ka qenë gruaja si bashkëshorte.

GjRrGj Tiranë: për të gjithë periudhën e monitorimit [janar 2011- maj 2012] nga totali i vendimeve të pushimit rezulton se në një mesatare prej 60 % të rasteve, kërkesë padia për zgjidhje martese është paraqitur nga gratë si bashkëshorte. E dhëna më e saktë do ishte: 61% të rasteve të monitoruara për 2011 dhe 59% të rasteve të monitoruara për vitin 2012. Pra mund të themi që aq sa aktive tregohen për të paraqitur padinë për zgjidhje martese, gratë si bashkëshorte duket se edhe më shumë kanë tendencën të tërhiqen nga procesi. Nga mënyra se si argumentohen shkaqet e pushimit, mendojmë se ato janë ligjore dhe plotësisht konform dispozitave procedurale civile. Pra pala paditëse tërhiqet nga kërkesa nëpërmjet deklarimit në seancë gjyqësore se heq dorë nga kërkesë padia ose megjithëse ka dijeni për datën dhe orën e gjykimit nuk paraqitet. Në disa vendime gjyqësore, kur padia ngrihet pas vendimit të pushimit, bashkëshortja me cilësinë e paditëses “deklaroi se disa herë ka paraqitur të njëjtën kërkesëpadi në gjykatë por është tërhequr duke besuar se i padituri do të ndryshonte mënyrën e të sjellurit me të”¹⁸.

17 Neni 299 i KPrC: “Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur:

- a) asnjëra prej palëve nuk kërkon brenda gjashtë muajve rifillimin e gjykimit të pezulluar me kërkesën e tyre, kur gjykata nuk ka caktuar në vendimin e pezullimit një seancë të ardhshme;
- b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë;
- c) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj.”

18 Vendim Nr.953, dt. 14.02.2011 i GjRrGj Tiranë.

Avokatet e QNL duke u nisur dhe bazuar në praktikën e ofrimit të shërbimit ligjor dhe përfaqësimit falas që u bëjnë këtyre grave, kanë mundësi të shkojnë në një analizë më të thellë dhe të ndajmë mendimin se këtu ndikojnë edhe faktorë të tjerë. Të tilla janë: paaftësia paguese për psikologun në rastet e çështjeve me të mitur, pasaktësitë në lidhje me adresën e palës së paditur dhe problematika të ndryshme sociale me të cilat gratë përballen, presioni i të afërmeve dhe mungesa e njohurive mbi ligjin dhe aksesin në ndihmën ligjore falas. Sikurse ka dalë nga studime të tjera dhe opinionet e marra nga gjyqtarët lidhur me vendimet e pushimit, ka raste që kur kërkesë padinë e bën bashkëshortja, realizohet një lloj pajtimi sa për sy e faqe aq sa çështja të pushohet me qëllim që më pas këtë kërkesë ta paraqesë vet bashkëshorti i cili për shkak të mentalitetit nuk e duron dot që “ta ndajë gruaja”¹⁹.

Në GjRrGj Durrës: për vitin 2011 nga vendimet e pushimit rezultojnë se në 66.6 % të rasteve kërkesë padia për zgjidhje martesë është paraqitur nga gratë, ndërsa për vitin 2012, nga vendimet e pushimit rezultojnë se në 75 % të rasteve kërkesë padia për zgjidhje martesë është paraqitur nga gratë. Shkaqet janë thuajse unikalë.

Rrethi	Viti	Vendime të monitoruara	Vendime të pushuara	Paditëse-gra %	Paditës- burra %
Tiranë	2011	618	147	90 gjithsej ose 61%	57 gjithsej ose 39%
	1 janar - 31 maj 2012	474	133	78 gjithsej ose 59%	55 gjithsej ose 41%
Durrës	2011	272	12	8 gjithsej ose 66.6%	4 gjithsej ose 33.4%
	1 janar - 31 maj 2012	151	4	3 gjithsej ose 75%	1 gjithsej ose 25%
Shkodër	2011	257	98	160 gjithsej ose 62.2 %	55 gjithsej ose 21.4 %
	1 janar - 31 maj 2012	79	12	47 gjithsej ose 59.4 %	17 gjithsej ose 21.5 %

Në rastin e të dhënave të Shkodrës, 16.4% e rasteve të vitit 2011 dhe 19.1% në vitin 2012 kanë të bëjnë me zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok nga të dy bashkëshortët. Këtu nuk janë zbritur vendimet e pushimit.


Ka një tendencë në rritje të zgjidhjes së martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve.

Martesa zgjidhet vetëm në rrugë gjyqësore. Veç bashkëshortëve, është shumë e rëndësishme që kjo e fundit, gjykata, të njohë dhe zbatojë me rigorozitet parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit të cilat bëhen edhe më të brishta e të ndjeshme në këto situata sa i përket pasojave që vijnë nga zgjidhja

19 Studimi “Të drejtat pronësore të grave” në proces botimi.

e martesës. Sipas dispozitave të KF, martesë mund të zgjidhet: me pëlqimin reciprok [neni 125 KF]; për ndërprerje të jetës së përbashkët [neni 129 KF]; me kërkesën e njërit bashkëshort [neni 132 KF].

Nga monitorimi ka rezultuar se ka një rritje të rasteve të zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve duke i paraqitur gjykatës njëkohësisht me kërkesën edhe një projekt marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së saj.



Zgjidhja e martesës me pëlqimin reciprok si një nga format e zgjidhjes së martesës, duhet të dëshmojë një shkallë të lartë përgjegjshmërie dhe përgjegjësie të bashkëshortëve. Procesi shndërrohet në seanca ndërgjegjësimi dhe proces edukues për palët dhe është çasti që këta të japin prova dhe të demonstrojnë që janë të vendosur në respektimin e ligjit dhe të njëri tjetrit moralisht dhe ligjërisht si ish bashkëshortë që kanë konsumuar jetë së bashku. Marrëveshja nuk mund të jetë e pranueshme nëse në të ka diferencime dhe mosbarazim ose në rast se barazia formale çon në pabarazi reale. Kjo e fundit edhe më e vështirë për tu vlerësuar realisht. Për këtë kërkohet vigjilencë nga ana e gjykatës. Ligji parashikon se refuzohet nga gjykata zgjidhja e martesës me pëlqim reciprok nëse kjo konstaton se marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve ose të njërit prej bashkëshortëve. Nga monitorimi del se nuk ka vendime të tilla ose vendime që bëjnë një analizë të tillë të thelluar. Kodi i familjes për të nxitur zgjidhjen me pëlqimin reciprok, parashikon mundësinë e riparimit të marrëveshjes brenda një periudhe tri mujore.

Sipas viteve të monitoruara kjo mënyrë e zgjidhjes së martesës [me pëlqimin reciprok] shkon nga 7% në 11% për GjRrGj Tiranë. Në këtë gjykatë kemi konstatuar 37 raste të zgjidhjes së martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve gjatë vitit 2011, nga 618 vendimeve të monitoruara dhe 58 raste vetëm në 5 mujorin e parë të vitit 2012 nga 474 që është totali i vendimeve të monitoruara për këtë vit. E shprehur në përqindje, nga vendimet e monitoruara për vitin 2011, pasi kemi zbritur çështjet e pushuara, 7% e çështjeve të vitit 2011 dhe 11% për vitin 2012, me objekt zgjidhje martesë, janë zgjidhur me pëlqimin reciprok. Nga monitorimi, konstatojmë se projekt marrëveshja në të gjitha rastet, kur çifti ka fëmijë, përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur. Për të parë tendencën e aplikimit të mënyrës së zgjidhjes së martesës me pëlqimin reciprok, kemi bërë këtë bilanc për GjRrGj Tiranë: Për vitin 2011 nga 37 vendime të zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok 8 janë vendime pushimi. Kështu që nga 29 vendime kemi 22 raste kur çifti ka arritur në marrëveshje dhe kanë fëmijë dhe në 7 vendime

çifti nuk ka pasur fëmijë. Për vitin 2012 nga 58 vendime të zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok 15 janë vendime pushimi. Nga 43 të tjerat, në 31 raste çifti ka pasur fëmijë dhe në 12 raste çifti nuk ka pasur fëmijë. Pra, siç vihet re për këtë gjykatë, ka një tendencë në rritje të aplikimit të kësaj mënyre zgjidhjeje të martesës ku prindërit bien dakord lidhur me pasojat mbi fëmijët dhe rregullimin e marrëdhënieve personale e pasurore pas zgjidhjes së martesës. Sipas nenit 127 të KF marrëveshja duhet të përmbajë lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar, nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe rregullimin e marrëdhënieve pasurore. Pra siç vihet re nga dispozita, ka disa pjesë të marrëveshjes që janë të detyrueshme dhe të tjera fakultative [marrëdhëniet pasurore]. Por çfarë na rezulton nga rastet e monitoruara? Përsa i përket kontributit në favor të bashkëshortit nevojtar, vëmë re se nuk kemi asnjë marrëveshje që ta përmbajë këtë. Nuk ka asnjë rast për vitin 2011 dhe janar- 31 maj 2012 ku për vendimet e zgjidhjes me pëlqim reciprok por edhe për të gjitha vendimet e tjera të monitoruara, të jetë zgjidhur me marrëveshje kontributi i secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar.

Krahasuar me totalin rastet e zgjidhjes së martesës me pëlqimin reciprok duken të pakta, por kundrejt traditës, themi që janë ecje përpara. Këto shifra tregojnë një tendencë në rritje drejt aplikimit të kësaj mënyre të zgjidhjes së martesës. E vlerësojmë këtë ‘përdorshmëri’ të kësaj alternative si një shenjë emancipimi të shoqërisë dhe si një përpjekje të bashkëshortëve për të gjetur zgjidhje adekuatë në të mirë të tyre dhe të fëmijëve, për sa kohë do të jenë ata vet që do të jetojnë me këto zgjidhje.

Për GjRrGj Durrës: edhe në këtë gjykatë ka rezultuar, nga monitorimi, se ka rritje të rasteve të zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve duke i paraqitur gjykatës edhe një projekt marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Kemi konstatuar 17 raste gjatë vitit 2011 dhe 31 tentative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim nga totali prej 272 çështjesh të monitoruara. Nga këto 27 raste kanë pasur sukses. (ose 10.3%) Kemi konstatuar 9 raste gjatë vitit 2012 dhe 16 tentative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim nga totali prej 151 vendimesh të monitoruara. Nga këto 14 raste kanë pasur sukses. (ose 9.5 %)

Për GjRrGj Vlorë: Konstatojmë se projekt marrëveshja/apo marrëveshja e arritur nëpërmjet ndërmjetësimit në të gjitha rastet përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur dhe nuk kemi asnjë rast që të jetë zgjidhur me marrëveshje kontributi i secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar. Për vitin 2011 nuk ka asnjë rast të zgjidhjes së martesës me pëlqimin reciprok, vetëm 3 raste në vitin 2012 martesë është zgjidhur me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve ose e kthyer në përqindje në rreth 3.7%. Nga monitorimi i vendimeve në këtë gjykatë është vënë re se gjykata, respektonte procedurën dhe palët në proces. Si psh. seanca e pajtimit realizohej gjithmonë, por që më tepër ishte formale sepse palët ishin të vendosura të zgjidhnin martesën. Vetëm në raste të rralla mund të jenë pajtuar bashkëshortët gjatë seancës së pajtimit.

Për GjRrGj Shkodër: 16.4% e rasteve të vitit 2011 dhe 19.1% në vitin 2012 kanë të bëjnë me zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok nga të dy bashkëshortët. Kërkuesit ishin të dy bashkëshortët dhe ata zbatojnë alternativën për zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok.

Për ilustrim, për GjRrGj Tiranë duke zbritur vendimet e pushimit kemi këto të dhëna:

Për GjRrGj Tiranë, për vitin 2011:

- 407 sipas nenit 132,

- 37 sipas nenit 125

- 27 sipas nenit 129.

(Totali gjithsej 471 vendime përfundimtare të zgjidhjes së martesës).

Ndërsa për periudhën 1 janar-31 maj 2012:

-271 sipas nenin 132,

-58 sipas nenit 125

-12 sipas nenit 129.

(Totali gjithsej 341 vendime përfundimtare z.m)

Zgjidhja e martesës me kërkesën e njërit bashkëshort mbetet mënyra më ‘e përdorshme’. Ndër shkaqet janë edhe ato që lidhen me stereotipat gjinore të ngulitura.

Siç rezulton edhe nga monitorimi është mënyra më ‘e përdorshme’ për zgjidhjen e martesës. Sipas nenit 132: “Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesë, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesë ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët.

Edhe për GjRrGj Durrës, na rezulton se meqë vetëm një numër i kufizuar rastesh [ndonëse në rritje] çojnë në zgjidhjen e martesës pëlqimin reciprok, pjesa tjetër veprojnë sipas metodës tradicionale më kërkesë padi nga njëri bashkëshort. Nga ana e gjykatës tregohet kujdes në evidentimin e shkaqeve të zgjidhjes së martesës por vetëm duke i listuar ato si shpjegime të palëve të dhëna gjatë procesit gjyqësor dhe jo si deduktime të analizës së saj. Në të gjitha rastet Gjykata e ka zgjidhur martesën pa përcaktuar fajësinë, kjo sipas kërtimeve të palëve në proces. Gjithsesi nga analiza e vendimeve rezulton të përmendura si shkaqe për zgjidhjen e martesës: xhelozia, dhuna, emigracioni, ndërhyrjet e të tretëve, mospërbushja e detyrimeve bashkëshortore, alkoolizmi, sjellja e pahijshme, vuajtja e një dënimi të rëndë në një vend të huaj, predikimi i fesë nga bashkëshortja dhe mospërputhje karakteri në rastet e tjera kryesisht për shkak të lidhjes në martesë me ndërmjetësim (shkuesi).

Për GjRrGj Vlorë kemi këtë panoramë: Ndër 171 padi të pranuar në vitin 2011 janë zgjidhur me këtë mënyrë 125 raste ose 73 %. Kurse në vitin 2012 në 79 padi të pranuar, 65 janë raste të tilla ose 82 %. Një shkak i evidentuar për zgjidhjen së martesave ishte gjendja ekonomike. Për shkak të gjendjes jo të mirë ekonomike kishte shpesh debate dhe konflikte ndërmjet bashkëshortëve të tilla që çonin në zgjidhjen e martesës. Këtu do të përmendnim dhe rastet e mosmenaxhimit të mirë të të ardhurave të familjes nga njëri prej bashkëshortëve si dhe rasti kur njëri prej bashkëshortëve kishte vesin e të luajturit në lojëra fati. Dhe ky shkak i fundit ishte shumë përcaktues në zgjidhjen e martesës. Gjithashtu një shkak tjetër konflikti që çonte në zgjidhjen e martesës ishte dhe bashkëjetesa me prindërit e ndonjërit prej bashkëshortëve. Kjo për shkak se gjatë kësaj bashkëjetese lindnin konflikte të ndryshme e të shumta që e bënin të pamundur vazhdimin e bashkëjetesës edhe ndërmjet burrit dhe gruas. Niveli arsimor dhe mendësia e bashkëshortëve gjithashtu ka qenë një shkak për mosbashkëpunim midis tyre duke çuar në zgjidhjen e martesës. Shkak tjetër është jetesa e bashkëshortëve në zonat rurale. Moszhvillimi i këtyre zonave ndikon drejtpërdrejt në mentalitetin dhe të kuptuarit ndërmjet bashkëshortëve në familje. Kjo gjë sillte grindje të shpeshta deri në zgjidhjen e martesës.

Në GjRrGj Shkodër, sipas të dhënave të monitorimit, rezulton se nga 336 vendime në total, duke zbritur 35 raste që është aplikuar neni 125, të tjerat, pra 301 ose 89% janë bazuar në kërkesën e njërit bashkëshort .

Ndërprerja e jetës së përbashkët si shkak për zgjidhjen e martesës paraqitet në numër të kufizuar rastesh

Sipas nenit 129 KF “Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh. Nëse është rasti, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës, sipas paragrafit të parë të këtij neni, duhet të përcaktojë në kërkesëpadinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër”. Në GjRrGj Tiranë, për vitin 2011 nga 471 vendime përfundimtare të zgjidhjes së martesës, pa vendimet e pushimit, kemi 25 vendime ku shkak i zgjidhjes

se martesës është ndërprerja e jetesës së përbashkët. Ndërsa për periudhën 1 janar-31 maj 2012 nga 341 vendime përfundimtare të zgjidhjes së martesës, pa vendimet e pushimit, kemi 12 vendime ku shkak i zgjidhjes së martesës është ndërprerja e jetesës së përbashkët. Për GjRrGj Vlorë janë 10 vendime për vitin 2011 dhe 3 për vitin 2012. Gjithashtu, monitorimi i vendimeve të GjRrGj Shkodër konfirmon mungesë të rasteve të zgjidhjes së martesës për ndërprerje të jetës së përbashkët.

2.2. Disa nga shkaqet e evidentuara për zgjidhjen e martesës dhe stereotipat gjinore

Keqtrajtimi dhe dhuna me bazë gjinore në familje si shkak i zgjidhjes së martesës

Në këto raste kemi evidentuar padi për zgjidhje martesë që pasojnë ose ngrihen njëkohësisht me kërkesat për UM ose UMM po jo vetëm. Keqtrajtimi dhe dhuna mund të mos kenë qenë pjesë e një UM apo UMM dhe rasti vjen për herë të parë me formatin e padisë për zgjidhje martesë. Për vitin 2011 nga monitorimi i vendimeve për GjRrGj Tiranë, janë konstatuar 94 raste dhune, nga të cilat 60 raste kanë të bëjnë me dhunë fizike dhe psikologjike, 18 raste vetëm me dhunë fizike dhe 16 raste vetëm me dhunë psikologjike. Sa i përket dhunës ndaj fëmijëve kemi këtë gjendje: dhuna në prani të fëmijëve referohet në 37 raste; dhuna e asistuar në 31 raste; dhuna e drejtpërdrejtë në 6 raste. Ndërkohë që viktima ka marrë një urdhër mbrojtjeje dhe kërkon zgjidhjen e martesës janë konstatuar 10 raste. Ndërsa për periudhën 1 janar -31 maj 2012 janë evidentuar 59 raste dhune, nga të cilat 43 raste me dhunë fizike dhe psikologjike, 11 raste vetëm me dhunë fizike dhe 5 raste vetëm me dhunë psikologjike. Dhunë në prani të fëmijëve: 11 raste; dhuna e asistuar - 7 raste; dhuna e drejtpërdrejtë në 4 raste. Me urdhër mbrojtje janë konstatuar 10 vendime të zgjidhjes së martesës.

Për të ilustruar, sjellim Vendimin Nr.953/14.02.2011 të GjRrGj Tiranë, ku mësojmë se bashkëshorti ka ushtruar ndaj paditëses dhunë fizike e psikologjike në mënyrë sistematike edhe në prani të fëmijëve. Paditësja deklaroi përpara gjykatës se disa herë ka paraqitur të njëjtën kërkesëpadi në gjykatë por është tërhequr duke besuar se i padituri do të ndryshonte mënyrën e të sjellurit me të.

Nga vendim Nr.9492/23.11.2011 i GjRrGj Tiranë, del se ndonëse martesë e çiftit është lidhur mbi bazën e njohjes dhe pëlqimit reciprok, ajo nuk ka funksionuar normalisht. Marrëdhëniet në çift kanë qenë gjithmonë të acaruar për shkak të konsumimit nga ana e palës së paditur të pijeve alkoolike dhe për pasojë ushtrimin prej tij të dhunës fizike dhe psikologjike ndaj bashkëshortes. Po kështu edhe në vendime të tjera del se xhelozia ndaj bashkëshortes ka shkakuar grindje dhe mosmarrëveshje të vazhdueshme të cilat kanë degraduar deri në dhunë psikologjike dhe fizike të të paditurit ndaj saj. I padituri duke qenë se nuk punonte filloi të luante bixhoz dhe më pas të mos interesohej për familjen e tij dhe me kalimin e kohës marrëdhënia në çift filloi të mos funksiononte, grindjet dhe mosmarrëveshjet të cilat ishin të përditshme dhe pjesë e jetës bashkëshortore derisa jeta e tyre u bë padurueshme²⁰.

Stereotipe në lidhje me rolin e gruas të drejtat, detyrimet bashkëshortore në familje dhe marrëdhëniet familjare

Kështu psh, në Vendimi nr. 16/13.01.2011 të GjRrGj Tiranë, në pjesën arsyetuese të vendimit

²⁰ Vendim Nr.3193/04.04.2012 i GjRrGj Tiranë.

gjejmë se “martesa është lidhur mbi bazën e ndërmjetësimit nga persona të tretë. Sipas shpjegimeve të palës paditëse, grindjet dhe kontradiktat për probleme të ndryshme, kanë lindur herët, shkak i të cilave ka qenë kryesisht trajtimi jo i mirë i paditëses. Duke qenë se palët ndërgjyqëse jetonin së bashku me prindërit e të paditurit, paditësja konsiderohej si grua për punë dhe për të përgatitur ushqimin dhe jo në mënyrë të barabartë me bashkëshortin e saj....”.

Stereotipe në lidhje me të drejtat ekonomike të bashkëshortëve, mënyrën e shpenzimeve financiare në familje dhe vendimmarrjen në lidhje me to.

Nga analiza që i bëjmë praktikës gjyqësore, siç është rasti i Vendimit nr. 96/18.01.2011 të GjRrGj Tiranë ku martesa është zgjidhur me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve, rezulton se ndonëse martesa midis palëve ka funksionuar për një kohë relativisht të gjatë dhe marrëdhëniet në çift kanë qenë të mira, duket se gjendet momenti që të shfaqet autoriteti i bashkëshortit që prish gjithë ekuilibrat. Në këtë rast duket se problemet kanë lindur kur bashkëshortja ka kërkuar të kthehet në Shqipëri pas 10 vjet emigracion ndërsa bashkëshorti nuk ka qenë dakord për shkak të pretendimeve të tij mbi vështirësitë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme. Duket se ndonëse palët kanë rënë dakord për tu kthyer, bashkëshorti vendos të rrijë më gjatë në Itali dhe pikërisht në këtë periudhë ai administron pasurinë dhe të ardhurat pa marrë mendimin e bashkëshortes”.

Mos përmbushja e detyrimeve në familje ndaj bashkëshortit/es dhe fëmijëve. Fenomeni ‘ludomania’

Fenomenit që quhet ‘ludomania’ duket se ka nisur të sjellë pasoja të rënda edhe në vende të tjera. Është fjala për dhënien dhe varësinë ndaj lojërave të fatit, bixhozit, etj të kësaj natyre. Duket se nga kjo nuk po shpëtojnë dot familjet shqiptare. Këtu nuk po kursehen as familjet me gjendje ekonomike vulnerabël. Ludomania është një varësi progresive që nis si argëtim dhe përfundon në patologji të rrezikshme për cilësinë e jetës individuale, familjare e kolektive. Pasoja e saj është edhe pamundësia e plotësimit të detyrimeve familjare dhe abuzimi me të ardhurat dhe pasurinë e familjes. Ky është shkak i zgjidhjes së martesës sjellë prej vendimit nr. 524/01.02.2011 i GjRrGj Tiranë i cili nuk është i vetmi në llojin e shkaqeve që rendit. “Bashkëshorti ka pasur ves lojërat e fatit duke shpenzuar shumë të mëdha parash të cilat ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjendjen e ekonomike të familjes, kalonte natën jashtë duke mos u kujdesur për fëmijët dhe bashkëshorten.” Kështu martesa humbet qëllimin e saj dhe bashkëjetesa është e pamundur.

2.3. Pasojat e vendimeve të zgjidhjes së martesës kundrejt bashkëshortëve dhe ushtrimi i përgjegjësisë prindërore

Nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore konstatohet se nga ana e gjykatës, në përgjithësi, tregohet kujdes në atë pjesë të procesit gjyqësor që ka lidhje me të drejtën e njërit prind apo të dy prindërve për të ushtruar përgjegjësinë prindërore për fëmijët e mitur, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Nëna është prindi që i lihen më së shumti fëmijët pas zgjidhjes së martesës dhe si e tillë ajo është ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore

Rrethi	Viti	Zgjidhje martesë		Ushtrues i përgjegjesisë prindërore			Zgjidhje me marrëveshje
		Me fëmijë	Pa fëmijë	Nëna	Babai	Të dy	
Tirana	2011	350	121	237	33	15	37
	01.01.- 31.05.2012	217	124	137	20	2	58
Durrës	2011	98	174	88	7	3	4
	01.01. - 31.05.2012	55	96	45	4	3	3
Vlorë	2011	76	41				
	01.01. - 31.05.2012	36	46	33	2	1	
	2011	198	59	115	14	30	42
Shkodra	01.01. - 31.05.2012	60	19	50	7	10	15

Sipas monitorimit të vendimeve në GjRrGj Tiranë, nëna e fëmijës është ajo që më së shumti rezulton të jetë ushtruesja e përgjegjesisë prindërore ndaj fëmijës së mitur. Ky është konkluzioni që del nga monitorimi.


Në 237 ose 88% të vendimeve të monitoruara për vitin 2011 dhe në 137 ose 87% të rasteve për vitin 2012 është nëna ushtruesja kryesore e përgjegjesisë prindërore. Pra, gjykata në të shumtën e rasteve ia lë të drejtën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore për fëmijët e mitur, nënës. Konstatohet se në çdo rast të tillë, gjykata shprehet edhe për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve të mitur. Siç u përmend edhe më sipër, praktika gjyqësore tregon se është rritur numri i zgjidhjes me marrëveshje të çështjeve në lidhje me të drejtën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore për fëmijët e mitur dhe detyrimin ushqimor ndaj tyre. Ky tregues efikon pozitivisht fëmijët, mirëqenien e tyre materiale dhe emocionale dhe marrëdhëniet midis ish bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës.

Tabela në vijim na jep të dhëna në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore për fëmijët e mitur sipas gjykatave. Siç vihet re, nga totali i çështjeve të monitoruara janë zbritur vendimet e pushimit.

Në rastet kur ushtrues të përgjegjesisë prindërore janë të dy prindërit do të thotë që çifti ka pasur dy ose më shumë fëmijë dhe gjykata ka vendosur ti ndajë ata ndërmjet dy prindërve, njeri me nënën, tjetri me babain. Në një rast të vetëm, gjykata ka operuar me një plan prindërimi dhe takimesh që gati krijon të drejtën për kontakte dhe vizita të barabarta midis të dy prindërve.

Edhe në vendimet e GjRrGj Durrës, vëmë re se nëna është prindi që i lihen më së shumti fëmijët dhe si e tillë ajo është ushtruesja kryesore e përgjegjesisë prindërore: në 90% të rasteve për vitin 2011 dhe në 82% të rasteve për 2012. Nga monitorimi u konstatua se gjykata në të shumtën e rasteve ia lë të drejtën e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore për fëmijët e mitur, nënës.

Konstatohet se në çdo rast, gjykata shprehet edhe për detyrimin ushqimor ndaj fëmijëve të mitur. Përsërisim rëndësinë që kanë proceset e zgjidhjes së pasojave me marrëveshje ose me ndërmjetësim jashtë gjyqësor. Në këtë gjykatë, ndërmjetësimi është alternativë e realizuar me sukses falë një projekti pilot me USAID. Në këtë mënyrë është rritur numri i zgjidhjes së pasojave të zgjidhjes së martesës me marrëveshje, në lidhje me të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për fëmijët e mitur dhe detyrimin ushqimor ndaj tyre. Ky tregues efektikon pozitivisht fëmijët, mirëqenien e tyre materiale dhe emocionale dhe marrëdhëniet midis ish bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës.



Për GjRrGj Vlorë nga monitorimi i vendimeve, kemi konstatuar se në lidhje me përgjegjësinë prindërore fëmijët në përgjithësi i liqeshin nënës, por ka pasur dhe raste përjashtimore që fëmijët mund ti liqeshin babait. Këto raste ndodhnin vetëm për arsye se fëmijët jetonin me babain ose për shkak të vërtetimit në seancë gjyqësore të dëshirës së fëmijëve për të ndënjur me babain. Kjo e fundit e bazuar dhe tek ekspertimi psikologjik, ku kishte raste që ekspertët shpreheshin që fëmija duhet ti liqej babait edhe për shkak të dëshirës së vet fëmijës. Gjithashtu eksperti vlerësonte gjendjen ekonomike të secilit prej palëve, gjendjen shëndetësore e morale, kushtet se si jetonin fëmijët. Dhe mbi bazën e këtyre argumenteve gjykata vendoste për të drejtën prindërore. Kishte dhe raste më të pakta kur ndahej përgjegjësia prindërore dhe fakti se kujt i liqej fëmija për rritje dhe edukim. Në këto raste është vendosur që njëri prej fëmijëve ti liqej nënës dhe tjetri babait²¹.

GjRrGj Shkodër: nga 226 vendime të dhëna [nga totali prej 336 kemi zbritur 110 çështjet e pushuara] në të gjitha vendimet e monitoruara, për periudhën Janar 2011- Qershor 2012, rezulton që fëmijët i janë lënë nënës si ushtruesja kryesore e përgjegjësive prindërore në 165 raste dhe vetëm në 21 raste prej tyre ky rol kryesisht i është lënë babait; në 40 raste është vendosur që për shkak se çifti ka më shumë se një fëmijë, ushtrimi i përgjegjësive të ndahet midis prindërve duke i lënë kështu fëmijë në kujdes edhe njërit edhe tjetrit.


Gjykata e rrethit Gjyqësor Shkodër: Për vitin 2011, nga 257 vendime, 98 prej tyre janë vendime pushimi dhe 159 vendime përfundimtare të zgjidhjes së martesës midis palëve. Në 159 vendime gjithsej në 115 raste, e drejta e ushtrimit të përgjegjësive prindërore për fëmijët e mitur i është lënë nënës, në 14 raste e drejta i është lënë babait dhe në 30 raste e drejta e ushtrimit të

21 Për vitin 2011 ishin 32 raste të tilla të çifteve me më shumë se dy fëmijë; për 2012 ishin 12 raste të tilla. Pra në këto raste fëmijët i janë lënë të dy prindërve.

përgjegjesisë prindërore i është lënë të dy prindërve. Për periudhën janar –maj 2012 nga 79 vendime të monitoruara në 67 prej tyre gjykata ka vendosur zgjidhjen e martesës dhe pasojave të saj midis palëve, ndërsa në 12 raste çështja është pushuar. Nga 67 vendime, në 50 raste e drejta e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore për fëmijët e mitur i është lënë nënës, në 7 raste e drejta i është lënë babait dhe në 10 raste e drejta e ushtrimit të përgjegjesisë prindërore i është lënë të dy prindërve.

Nuk ka një konkluzion kategorik për të gjitha gjykatat lidhur me faktin nëse ndër çiftet që zgjidhin martesën dominojnë çiftet me fëmijë. Kjo qëndron për Tiranë, Vlorën e Shkodrën por jo për Durrësin.


Rreth 60 % e çifteve që zgjidhin martesën janë ata që kanë fëmijë nga martesja. Ky është konkluzion për Tiranën. Për GjRrGj Tiranë, është rreth 64% numri i çifteve që zgjidhin martesën dhe që kanë pasur fëmijë nga lidhja e tyre për vitin 2011 dhe 57% për vitin 2012 sa është periudha e përfshirë në këtë monitorim. Pra mesatarisht le të themi se 60% e çifteve janë me fëmijë.



GjRrGj Vlorë: Për vitin 2011 nga rastet e monitoruara në përqindje më të madhe ishin zgjidhjet e martesave me fëmijë dhe më të pakta rastet kur nga martesja nuk ishin lindur fëmijë. Gjithsej janë 137 ose 74 % vendime ku çiftet që zgjidhin martesën kanë fëmijë dhe 76 ose 34% raste që çiftet nuk kanë fëmijë. Në parim proceset gjyqësore të zgjidhjes së martesave pa fëmijë përfundonin më shpejt se sa ato me fëmijë. Për vitin 2012, duhet të themi se nga 82 vendime të monitoruara, në 46 ose 56% prej tyre çifti nuk ka pasur fëmijë. Kështu që 36 ose 44% janë rastet e zgjidhjes së martesës së çifteve me fëmijë. Ndër këto raste, në 33 raste ose 89% të rasteve fëmija/ët i është lënë nënës, në 3 raste ose 8% të tyre i është lënë babait, në 1 rast ose 3% të tyre të dy fëmijët i janë lënë në kujdestari 1 nënës e 1 babait [kjo është arsyeja e ndryshimeve në total].

GjRrGj Shkodër: këtu, pjesa më e madhe e çifteve që zgjidhin martesën janë ata që kanë fëmijë. Siç rezulton dhe nga shifrat, nga totali prej 336 për të dy vitet, në 258 vendime ose 76.7 % të rasteve rezulton që çiftet kanë pasur fëmijë.

Për GjRrGj Durrës, numri i çifteve me fëmijë që zgjidhin martesën është më i ulët se numri i çifteve pa fëmijë. Sipas statistikave të monitorimit, numrin më të madh të zgjidhjeve të martesës e kanë çiftet pa fëmijë. Në përqindje në favor të çifteve pa fëmijë shkon 64%:36% edhe për vitin 2011 edhe për rastet e monitoruara në vitin 2012 [5 muaj].



Gjykata tregon gjithnjë vëmendje dhe kujdes për përfshirjen e psikologut në proceset me të mitur me qëllim përcaktimin e planeve të prindërimit pas zgjidhjes së martesës

Vlerësojmë se gjykatat në të gjitha rastet e monitoruara ka zbatuar nenin 155 të K.F²², duke thirrur psikologun ose punonjës social para se të marrë vendimin e përkohshëm ose përfundimtar në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish bashkëshort ose një personi të tretë.

Konstatim i monitoruesit të vendimeve të GjRrGj Vlorë është se caktimi i një psikologu në rastin kur kishte fëmijë konsiderohet një pjesë e rëndësishme e procedurës. Në rastet kur bashkëshortët nuk kishin fëmijë çështjet përfundonin shpejt sepse nuk kishte probleme të shumta. Në rastin kur gjatë martesës kishin lindur fëmijë gjykata pasi dëgjonte mendimin e psikologut dhe shikonte kushtet e jetesës së secilit prej bashkëshortëve, në përgjithësi, ia linte fëmijët për rritje e edukim nënës duke i caktuar babait ditët se kur do i takonte fëmijët. Gjithashtu gjykata përcaktonte edhe detyrimin ushqimor të babait për fëmijët. Gjykata tregohej e kujdesshme në aspektin e mosdiskriminimit të fëmijëve nga ndonjëri prej prindërve. Gjykata pasi dëgjonte dhe ekspertin psikolog, duke vlerësuar të gjitha provat si dhe hetimin gjyqësor vendoste lënie e fëmijës për rritje dhe edukim pranë atij prindi që jo vetëm i siguronte kushte më të mira, por dhe pranë atij prindi i cili nuk do të diskriminonte të drejtat e fëmijëve në lidhje me takimet apo marrëdhëniet me prindin tjetër. Në seancë në mënyrë që të mos diskriminonte asnjërin prej palëve duke iu dhënë të drejta të barabarta dhe mundësi të barabarta për të provuar faktet që ata pretendonin.

Edhe për GjRrGj Shkodër, në të gjitha vendimet me objekt zgjidhje martese, gjykata është treguar mjaft e kujdesshme, duke mundësuar përfshirjen e psikologut në proceset me të mitur, duke tuteluar interesin më të lartë të fëmijës dhe njëkohësisht duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e prindërve pas zgjidhjes së martesës.

I njëjti konstatim vlen për Tiranën dhe Durrësin.

22 Neni 155 I KF: “Para se gjykata të marrë një vendim të përkohshëm ose përfundimtar lidhur me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, të drejtës së vizitës ose të besuarit të fëmijës njërit ish-bashkëshort, duhet të thërrasë një psikolog ose punonjës social, i cili, para se të japë mendimin, duhet të marrë të dhëna për gjendjen materiale dhe morale të familjes, kushtet në të cilat jetojnë dhe ku është më e përshtatshme të jetojë fëmija”.

Është tipologji e vendimeve gjyqësore që në arsyetimin e vendimit lidhur me prindin që ushtron kryesisht përgjegjësinë prindërore gjykata ndalet tek figura e nënës të cilën e merr gjerësisht në analizë. Këtë analizë e kemi përqendruar kryesisht në GjRrGj Tiranë

Ajo që të bie në sy në vendimet e monitoruara, është pjesa arsyetuese e vendimit ku konstatohet se gjykata përpara se të vendosë për të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për fëmijët e mitur, bën analizën e figurës së prindit. Kjo analizë në fakt duket se, së shumti, i dedikohet nënës. Pra, ka një analizë të gjerë për figurën e saj, aftësinë, lidhjet me fëmijët, mundësinë ekonomike, etj. Jemi të mendimit se gjykata duhet të bëjë një analizë më të plotë dhe të baraspeshuar edhe në lidhje me figurën e babait si në rastet kur i lihet fëmija për rritje dhe edukim ashtu edhe në rastet e të drejtës së takimit të babait me fëmijët. Kështu, gjykata duhet të analizojë, pse nuk është babai prindi më i përshtatshëm ose pse babai duhet të këtë takime të shpeshta ose të kufizuara me fëmijët. Kjo vlen edhe për një arsye tjetër. Dinamika e jetës familjare dhe e interesit të fëmijës apo e të drejtës së fëmijës mund të kërkojë ndryshimin e vendimit lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore. Kjo mund të bëhet edhe menjëherë me apelimin e vendimit të parë edhe me kërkesën për ndryshim të këtij vendimi kur kushtet dhe rrethanat ndryshojnë. Gjykata që do të bëjë ‘rivlerësimin’ e përshtatshmërisë së prindit kërkues për të ndryshuar planin e prindërimit në favor të vet, duhet të njohë mirë arsyet që e shtynë gjykatën e dikurshme të merrte një vendim të caktuar. Kjo jo për të paragjykuar, por për të vlerësuar sa më drejt arsyet që e justifikojnë këtë ndryshim kundrejt ndryshimit të kushteve e rrethanave të mëparshme ose kundrejt ndryshimit të shkaqeve që më parë janë konsideruar jo në favor të lënies së fëmijës prindit kërkues.

Kështu psh, në vendimin nr.3428/20.04.2011 të GjRrGj Tiranë, me objekt zgjidhje martese, ndërkohë që gjykimi është bërë në mungesë të bashkëshortit, at i 5 fëmijëve ky, gjykata, duke vlerësuar edhe mendimin e psikologut ka bërë një analizë të figurës së nënës dhe të pamundësive të saj për rritjen e fëmijëve²³. Sipas nenit 224 të KF, *“kur prindi është në pamundësi të ushtrojë përgjegjësinë prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda, fëmija mund t’i besohet një anëtarit të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni të përkujdesjes. Në këtë rast merret mendimi i sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale, sipas dispozitave për kujdestarinë.”* Pra në rastin objekt analize, nëna duket se është në pamundësi për shkaqe të lidhura me gjendjen e saj shëndetësore ndërsa ati është në mungesë dhe mungesa është një nga shkaqet e pamundësisë (!?). Gjithsesi, nuk gjejmë në vendim asnjë analizë a vlerësim të qasjes më të mirë të interesit më të lartë të fëmijëve me babain sikurse nuk gjejmë asnjë analizë të figurës së atit për të bërë bilancin se si do të ushtrohet përgjegjësia prindërore. Pra, fëmijët janë lënë nën kujdesin e atit, i cili ka qenë në mungesë dhe nuk dihet asnjë gjë për të. Pa dyshim që gjykata është në vështirësi që në rrethana të tilla të vlerësojë interesin më të lartë të fëmijës, por duket se një vendim i tillë nuk e zgjidh problemin. Nëna në pamundësi dhe babai në ‘drejtim të paditur’. Është një rast që gjykata duhet të shprehet për kujdestarinë e fëmijës. Në këtë vendim vlen të përshtatshmet fakti që, gjykata çmon që **kryesisht** të shprehet për mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pavarësisht faktit se nuk përbën objekt të padisë. Ky është një aspekt pozitiv dhe në interes të fëmijës por në rastin konkret mungesa e atit gjatë procesit, pamundësia e vlerësimit të tij, neglizhenca dhe mosinteresim për fëmijët, e bën thuaj të vështirë zbatimin e këtij vendimi. Po kështu në Vendimin nr.5941/05.07.2011²⁴ analiza përqendrohet vetëm në figurën e nënës të cilës i

23 Në raportin e saj psikologjik ekspertja psikologe, rekomandon: Duke iu referuar pamundësisë së nënës së fëmijëve për të rritur dhe edukuar fëmijët e saj, gjendjen e saj të rëndë shëndetësore dhe emocionale rekomandoj: Lënien e fëmijëve F, V, L, N dhe E për rritje dhe edukim babait të tyre F.C. Duke patur parasysh rëndësinë që ka figura e nënës në jetën e fëmijëve rekomandoj takime të shpeshta e të qëndrueshme të fëmijëve me nënën.

24 Shih gjithashtu Vendimet 4584/ 2011 dhe vendimin nr1025/2012.

lihet fëmija për rritje dhe edukim pa asnjë konkluzion apo analizë mbi figurën e atit me qëllim që të dalë qartë se ku, pranë cilit prind realizohet më mirë interesi më i lartë i fëmijës.

Bashkëshorti është subjekti që më së shumti është ‘në mungesë’ në proceset me objekt zgjidhje martesë.

Ka raste, jo të pakta, që zgjidhja e martesës bëhet në mungesë të bashkëshortit/es. Sipas procedurës civile, këto njihen si vendime ku respektohet procedura e njohur si e ‘vendimeve me shpallje’, por që në fakt është fjala për njoftimet me afishim²⁵. Monitoruesit raportojnë që më së shumti këto janë procese gjatë zhvillimit të të cilave mungon bashkëshorti. Nga monitorimi në GjRrGj Tiranë, na ka rezultuar që në pjesën më të madhe në mungesë janë bashkëshortët dhe këto janë raste të zgjidhjes së martesës kur çifti *ka fëmijë*. Rastet e mungesës së bashkëshortit në seancë përfshijnë dy llojet e mungesës: rastin kur bashkëshorti ka dijani dhe nuk dëshiron të paraqitet, ashtu edhe rastin e mungesës me afishim ose me shpallje sepse nuk ka asnjë të dhënë për vendndodhjen e tij. Pa dyshim që një problem i përsëritur është ai i adresave.

Vihet re se, edhe kur gjatë procesit të zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të ushtrimit të përgjegjësisë ndaj fëmijës ati i fëmijës është në mungesë, gjykata kujdeset për marrëdhëniet e kontaktet e fëmijës me atin

Në këto raste ajo që kemi konstatuar është se, ndonëse në mungesë të babait të fëmijëve, gjykata vendos duke i dhënë të drejtën e takimit dhe të drejtën për të marrë fëmijën me pushime babait, pa bërë asnjë analizë rreth tij, figurës së tij, etj. Janë kryesisht rastet kur edhe psikologu/punonjësi social nuk ka mundur të kontaktojë me babanë sepse ai është në emigracion, nuk ka një adresë të saktë dhe nuk komunikon me familjen. Në fakt vendime të tilla vënë në dyshim mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe veç kësaj mbeten thuajse të pazbatueshme në këtë pjesë. Përgjithësisht në vendime të tilla, lidhur me planin e kontakteve prind fëmijë, edhe kur prindi është në mungesë, kemi të njëjtin dispozitiv si në rastet e pranisë së prindit. Vendimet nuk janë të diversifikuara bazuar në një analizë adekuate rast pas rasti dhe të aplikimit të parimeve të KDF dhe të KF në këto raste. Ndajmë mendimin se në raste të tilla, gjykata mund të parashikojë një plan prindërimi dhe kontaktesh më të kufizuara për këtë prind. Nëse kjo konsiderohet si shkelje e të drejtave nga ana e tij, atëherë ekziston mundësia e ndryshimit të vendimit.

Na duket me interes statistika e mëposhtme për GjRrGj Tiranë:

Për vitin 2011 nga 618 vendime të monitoruara në total, 147 janë vendime pushimi, ndërsa 471 janë vendime përfundimtare të zgjidhjes së martesës. Nga 471 vendime, 286 janë vendime të zgjidhjes së martesës ku prindërit kanë fëmijë.

- *Nga 286 vendime të çifteve me fëmijë, fëmija i është lënë vetëm nënës në 237 vendime dhe nga këto babai ka qenë në mungesë në 74 vendime. Nga 286 vendime me fëmijë, fëmija i është lënë vetëm babait në 33 vendime dhe nga këto nëna ka qenë*

25 Sipas nenit 133 të KPrC (Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 4)(Ndryshuar dhe shtuar me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2012, neni 12)kemi: “Kur personit të thirrur nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, ose nuk ka zgjedhur një banesë, apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, sipas nenit 131 të këtij Kodi, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit, ku do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit. Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë.”

në mungesë në 13 vendime. Nga 286 vendime fëmijët janë lënë edhe nënës edhe atit në 15 vendime. Në këtë shifër të fundit është rasti kur prindërit kanë patur më shumë se një fëmijë të cilët nuk i janë lënë të njëjtit prind.

Për vitin 2012

Nga 474 vendime të monitoruara në total, 133 janë vendime pushimi, ndërsa 341 janë vendime përfundimtare të zgjidhjes së martesës. Nga 341 vendime, 159 janë vendime të zgjidhjes së martesës ku prindërit kanë fëmijë. Nga 159 vendime me fëmijë, fëmija i është lënë vetëm nënës në 137 vendime dhe nga këto babai ka qenë në mungesë në 37 vendime.

- *Nga 159 vendime me fëmijë, fëmija i është lënë vetëm babait në 20 vendime dhe nga këto nëna ka qenë në mungesë në 6 vendime. Nga 159 vendime fëmijët janë lënë edhe nënës edhe atit në 2 vendime.*

Për të dyja periudhat e monitoruara: *Nuk ka asnjë vendim ku të mos ketë caktim të të drejtës së takimit me fëmijën/fëmijët kur njeri nga prindërit ka qenë në mungesë²⁶.*

Kështu sipas Vendimi nr.408/28.01.2011 të GjRrGj Tiranë, ndonëse gjykimi është zhvilluar në mungesë dhe me shpallje dhe bashkëshortja paditëse ka pretenduar se i padituri shpenzonte shumë kohë duke luajtur bixhoz dhe për rrjedhojë i është shmangur përgjegjësive si bashkëshort dhe si prind në mirërritjen e fëmijëve, duke mos kontribuar për familjen, përsëri, në dispozitivin e vendimit gjejmë se “I padituri ... ka të drejtë të takojë fëmijët e tij të shtunën e parë dhe të tretë të çdo muaji, nga ora 16.00 e ditës së shtunë, deri në orën 16.00 të ditës së diel, si dhe ta mbajë një muaj në pushimet verore.” Në pjesën arsyetuese gjejmë: “Gjykata nisur nga interesi më i lartë i fëmijëve, shpjegon se babait nuk duhet t’i kufizohet asnjëherë e drejta e takimit me fëmijët, *sa herë që ai të ketë mundësi* pasi çmon se është në interesin me të lartë të tyre që të kenë një raport sa më të afërt me të atin, raport i cili ndikon në edukimin, gjendjen emocionale dhe jetën sociale. Gjithashtu, Gjykata rekomandon edhe pse fëmijët i janë lënë për rritje dhe edukim nënës, ata duhet të kenë një komunikim dhe marrëdhënie afektive edhe me të atin, i cili mundëson një mirërritje të tyre”. Pra, në vendim nënvizohet se e drejta e takimit është pro atit dhe e disponueshme sa herë që ky ka mundësi dhe nuk është konsideruar si detyrim ndaj fëmijës kundrejt përgjegjësive prindërore. Po kështu edhe në Vendimin nr.524/ 01.02.2011 që është një vendim i dhënë në mungesë të të paditurit, at i fëmijëve ky, “këtij të fundit i njihet e drejta të takojë dhe të mbajë në banesën e tij të dy fëmijët çdo ditë të shtunë nga ora 18.00 deri në orën 11.00 të ditës pasardhëse dhe për pushime vjetore në periudhën 16-31 gusht të çdo viti kalendarik. Edhe në këtë vendim paditësja pretendon se i padituri ka pasur ves lojërat e fatit duke shpenzuar shumë të mëdha parash të cilat ndikonin në mënyrë të drejtpërdrejt në gjendjen e ekonomike të familjes, kalonte natën jashtë duke mos u kujdesur për fëmijët dhe bashkëshorten. Gjendja e tij e alkoolizuar shkaktonte shumë debate në familje, të cilat në të shumtën e rasteve zhvilloheshin edhe në prani të fëmijëve duke u shoqëruar me ofendime e dhunë psikologjike”.

Në rastin e GjRrGj Durrës, në rastet kur zgjidhja e martesës bëhet në mungesë të bashkëshortit, babait të fëmijëve, gjykata vendos duke i dhënë të drejtën e takimit dhe të drejtën për të marrë fëmijën me pushime babait, pa bërë asnjë analizë rreth tij. Janë kryesisht rastet kur edhe psikologu/punonjësi social nuk ka mundur të kontaktojë me babanë sepse ai është në emigracion, nuk ka një adresë të saktë dhe nuk komunikon me familjen.

26 Shih Vendimin nr. 1036/2011 dhe Vendimin 1632/2012 të GjRrGj Tiranë në të cilat konkludohet për takime të pakufizuar të fëmijës me babain ndonëse ky i fundit ka qenë në mungesë gjatë procesit të gjykimit.

Dispozitat më pak të kërkuara dhe zbatuara janë ato që kanë efekt mbi të drejtat e grave si bashkëshorte dhe që efektojnë pozitën e tyre ekonomike pas zgjidhjes së martesës

Kodi i familjes është i pajisur me disa dispozita që synojnë mbrojtjen e anëtarëve të familjes në situata krize familjare dhe pasigurie. Është fjala për rastet kur gjendja emocionale është e paqartë, kur martesë ende nuk është zgjidhur por ndërkohë ka disa të drejta e detyrime të cilat për nga rëndësia nuk mund të presin marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata. I tillë është neni 139 mbi ‘Marrjen e masave të përkohshme’²⁷. Gjithashtu me rëndësi është neni 192 dhe 199 i KF të cilët përmbajnë rregullime lidhur me ‘detyrimin për ushqim ndërmjet bashkëshortëve’ të cilët pavarësisht se i japin fund martesës kanë ende detyrime kundrejt njërit tjetrit²⁸. Një tjetër dispozitë me rëndësi të veçantë është neni 153 i KF që përmban parashikime lidhur me të drejtën e përdorimit të banesës familjare, pavarësisht se kush ka qenë pronar i saj. Sipas të dhënave të monitorimit për GjRrGj Tiranë, për vitin 2011, neni 153 është vendosur në bazën ligjore vetëm në 2 raste dhe vetëm në 1 vendim citohet në tekstin e arsyetimit; në 2 raste është kërkuar zbatimi i këtij neni, por është rrëzuar nga gjykata²⁹. Për vitin 2012, neni 153 përmendet vetëm në një vendim në bazën ligjore.

Pra, është e dukshme që të drejtat e përfshira në këto nene, edhe kur shkaqet ekzistojnë nuk kërkohen gjyqësisht. Në këtë mënyrë, gama e kërkesave mbetet në pretendime shumë të njohura dhe që kanë praktikë të konsoliduar pa u ndalur në respektimin e instituteve të reja që sigurojnë një mbrojtje më adekuatë.

Nisur nga statusi ekonomik i familjeve shqiptare, neni 147 i KF parashikon detyrimin për kontribut kompensues. Ky kontribut nuk konkurren me detyrimin për ushqim por qëndron më vete si një detyrim që bashkëshorti të ruajë të njëjtën *status quo* ekonomike që kishte gjatë martesës. Siç rezulton nga monitorimi nuk ka raste të zbatimit të këtyre dispozitave të KF.

Pa dyshim që në kushtet e realiteti shqiptar, këto dispozita, ndonëse neutrale nga këndvështrimi gjinor, kanë impakt pozitiv ndaj grave nëse kërkohen në proceset gjyqësore dhe zbatohen. Avokatet e QNL mendojnë se kjo lidhet me nivelin e njohjes së këtyre dispozitave me efekte gjinore, me mentalitetin shoqëror dhe ndërgjegjësimin e ulët të profesionistëve për ti kërkuar ato.

Sikurse konkludua, në rastin e monitorimit të vendimeve për GjRrGj Tiranë, edhe në GjRrGj Durrës nuk ka raste të zbatimit të këtyre dispozitave të KF: fjala për nenin 139 të Kodit të Familjes mbi “marrja e masave të përkohshme”; të nenit 192 dhe 199 i KF, në lidhje me detyrimin për ushqim ndërmjet bashkëshortëve; të nenit 153 të KF, mbi “e drejta e përdorimit të banesës”; të nenit 147 të KF, mbi “kontributi kompensues”, etj. Monitoruesit, në përgjithësi, ndajnë mendimin se kjo lidhet me mos njohjen e këtyre dispozitave me efekte gjinore, me mentalitetin shoqëror dhe nevojën e ndërgjegjësimit të bashkëshortëve dhe profesionistëve, kryesisht avokatëve për ti kërkuar ato.

27 Neni 139 “Marrja e masave të përkohshme”: Gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të marrë masa të përkohshme për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të mitur, për detyrimin për ushqim të bashkëshortit, kur shihet e arsyeshme, për sigurimin e banimit, si dhe administrimin dhe përdorimin e pasurisë së vënë gjatë martesës, nëse është rasti.

Vendimi për marrjen e një mase të përkohshme ka fuqi derisa të jepet vendimi përfundimtar, por ai mund të ndryshohet ose të shfuqizohet nga gjykata, kur çmon se kanë ndryshuar rrethanat ose kur vendimi është marrë mbi të dhëna jo të sakta.

28 Për vitin 2011: Neni 192/a dhe 199 i KF - për detyrimin ushqimor të bashkëshortit ndaj bashkëshortit tjetër është hasur në 1 rast të gjitha vendimeve të monitoruara dhe është rrëzuar nga gjykata (vendimi nr. 4684/2011). Për vitin 2012: -Neni 192/a dhe 199 i KF - për detyrimin ushqimor të bashkëshortit ndaj bashkëshortit tjetër është hasur në 1 rast të gjitha vendimeve të monitoruara dhe është rrëzuar nga gjykata si e pa mbështetur në ligj (vendimi nr. 158/2012).

29 Shih vendimin nr.4684/2011 dhe vendimi nr. 7425/2011 të GjRrGj Tiranë.

2.4. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore për çështjet me objekt pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore

Çështjet pasurore janë shumë sensitive por edhe të rëndësishme për statusin ekonomik të familjes. Kemi vënë re se edhe në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe të zbatimit të dispozitave të Ligjit të Dhunës [shkurtim i ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” të vitit 2006, ndryshuar] ku subjekt i mbrojtur janë ish bashkëshortët, ka rezultuar se një nga faktorët e prezencës së formave të ndryshme të dhunës është edhe pasuria bashkëshortore dhe tendenca e ish bashkëshortëve për ta gëzuar atë realisht në natyrë duke iu mohuar grave çdo të drejt pasurore.

Gratë janë më aktive në paraqitjen e padive për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore civile me objekt pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore ka rezultuar se: për vitin 2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar 34 vendime nga të cilat në 24 vendime kërkesa për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore është paraqitur nga ish bashkëshortja dhe në 10 raste nga ish bashkëshorti. Për periudhën 1 janar – 31 maj 2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar 20 vendime dhe nga këto në 13 raste kërkesa është paraqitur nga ish bashkëshortja dhe në 7 raste paditës është ish bashkëshorti. Rezulton se për periudhën objekt monitorimi nga 1 janar 2011 deri në 31 maj 2012 shifrat flasin se **në 69% të rasteve kërkesa përpara gjykatës për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore është paraqitur nga gratë.**

Për GjRrGj Durrës, kemi 11 raste për vitin 2011. Nga këto, në 6 raste ose 55% të tyre çështja është pushuar për shkak të mosparaqitjes së bashkëshortes si paditëse. Në 5 rastet e mbetura, 3 vendime janë dhënë në favor të bashkëshortit, 1 rast është zgjidhur me pajtim dhe në 1 është proceduar me kthimin e akteve. Për vitin 2012 kemi vetëm 6 raste të pjesëtimin të pasurisë bashkëshortore. Në 2 raste ose 25% të tyre çështja është pushuar sepse nuk është paraqitur paditësja. Ndër 4 çështjet e pranuar vëmë re se në raportin 3 me 1 pasuria është pjesëtuar në favor të bashkëshortit.

Bashkëshortët janë më pak aktivë se sa bashkëshortet në paditë e pjesëtimin të pasurisë bashkëshortore sepse ata gëzojnë *de facto* pasurinë dhe nuk kanë ‘interes’ nga pjesëtimi gjyqësor

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore, statistikave tregojnë se kërkesa për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore gjyqësisht ndonëse është e drejta e secilit bashkëshort, aplikohet më shumë prej grave. Vet fakti se rreth 69% të kërkesave në GjRrGj Tiranë janë paraqitur nga gratë të çon në përfundimin se janë ish bashkëshortët ata që e gëzojnë realisht pasurinë bashkëshortore dhe si të tillë nuk kanë interes për pjesëtimin e saj. Edhe në GjRrGj Durrës gratë janë më aktive në paraqitjen e kërkesave si dhe në mosparaqitjen në gjykim çka çon në pushimin e çështjes.

Shumica e vendimeve të pjesëtimin të pasurisë ku paditëse janë gratë, pushohen. Monitorimi për GjRrGj Tiranë na e jep këtë të dhënë për mbi 70% të këtyre vendimeve.

Për vitin 2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar 34 vendime me objekt pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore. Nga këto, 21 vendime ose 62% janë vendime pushimi. Ndër këto, 15 vendime ose 71% tyre, është paditëse ish bashkëshortja. E njëjta panoramë na shfaqet edhe për vendimet e monitoruara për periudhën janar-maj 2012. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar 20 vendime dhe nga këto 11 vendime ose 55% janë vendime pushimi në të cilat 9 vendime ose 82% të tyre paditëse është ish bashkëshortja.

Viti	Vendime të monitoruara	Të pushuara Gjithsej	%	Paditëse Ish-bashkëshortja	%
2011	34	21	62	15	71
1 janar-31 maj 2012	20	11	55	9	82

Tabela më sipër është për vendimet e GjRrGj Tiranë për çështjet me objekt nenin 207 të KC lidhur me pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore.

Nga monitorimi i këtyre çështjeve ne GjRrGj Tiranë, nga përmbajtja e kufizuar e asaj çka shkruhet në vendim, na rezulton se në vitin 2011 ndër 21 vendime të pushuara, në 2 raste ose 10% si shkak është vlerësuar se pala paditëse ka kërkuar pushimin e gjykimit dhe në 19 ose 90% raste të tjera, megjithëse pala paditëse ka marrë dijeni për datën e gjykimit nuk është paraqitur në gjykatë. Ndërsa për periudhën janar- maj 2012 ka rezultuar se ka një tendencë pozitive në zgjidhjen e këtyre konflikteve midis ish bashkëshortëve. Kështu, ndër 11 raste të pushuara, në 3 prej tyre ose 27% çështjet janë zgjidhur me pajtim; në 8 raste ose 73% gjykata ka pushuar gjykimin pasi pala paditëse megjithëse ka marre dijeni dhe nuk është paraqitur në gjykim. Në të gjitha rastet e pushimit, GjRrGj Tiranë i është referuar nenit 179³⁰ të KPrC dhe 299/b³¹ të KPrC dhe ka pushuar gjykimin.

Tërheqja nga gjykimi me qëllim pushimin e çështjes është pa dyshim një e drejtë ligjore. Por, numri i lartë i grave që tërhiqen nga gjykimi i çështjes për të pjesëtuar gjyqësisht pasurinë bashkëshortore, duket se nxitet edhe nga faktorë të tjerë social- ekonomik apo dhe mungesë informacionit juridik.

Avokatet e QNL në veprimtarinë e tyre gjatë shërbimit ligjor falas për periudhën nga 1 janari 2011 deri në maj 2012 kanë këshilluar rreth 40 gra për procedurat ligjore dhe dokumentacionin e nevojshëm për pjesëtimin gjyqësisht të pasurisë bashkëshortore. Kuptohet që kjo qendër nuk mund të plotësojë të gjitha nevojat për ndihmë ligjore. Përgjegjësia e shtetit duhet të dalë më mirë në pah. Për GjRrGj Durrës në 35% të rasteve në total çështja pushohet dhe në të gjitha këto raste, pra 100% paditëse është ish bashkëshortja dhe me të drejtë mund të komentojmë që pushimi jo në të gjitha rastet ka si prapavijë zgjidhjen me marrëveshje jashtëgjyqësisht.

Nga vendimet gjyqësore të monitoruara në GjRrGj Tiranë, vihet re se gratë janë përfitueset kryesore të kthimit në natyrë të pasurisë bashkëshortore

Nga monitorimi i vendimeve gjyqësore në lidhje me këtë çështje konstatojmë se në rastet kur prona bashkëshortore pjesëtohet gjyqësisht ka rezultuar se edhe gratë (si ish bashkëshorte) janë përfituese në natyrë të pasurisë bashkëshortore. Kështu për shembull për vitin 2011, ka rezultuar se janë 13 vendime [pasi kemi zbritur nga totali vendimet e pushimit] me të cilat gjykata ka vendosur pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore dhe në 7 raste është vendosur që prona në natyrë i është dhënë në pronësi gruas (ish bashkëshortes) dhe burri (ish bashkëshorti) është kompensuar prej saj në vlerë leku.

30 Ky nen parashikon pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve.

31 Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ... b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë; ...

III

Gjetje kryesore nga monitorimi i vendimeve gjyqësore dhe praktikës së QNL-së për çështjet me objekt lëshimin e urdhrave të mbrojtjes.

Konstatohet një rritje në numër e kërkesave për UM/UMM ndonëse gjendja nuk pasqyrohet saktë ne faqen e të dhënave të gjykatës

Si del nga monitorimi i vendimeve lidhur me UMM/UM për periudhën janar 2011 – maj 2012, për GjRrGj Tiranë, është konstatuar një rritje e numrit të kërkesave për UMM/UM gjatë vitit 2011 dhe gjatë 5 mujorit të parë të vitit 2012, e krahasuar kjo me vitet e mëparshme të monitoruara nga QNL. Ajo që vihet re është që gjykata, në përgjithësi, nuk i pasqyron të gjitha rastet e UM/UMM në database, dhe kështu, ndodh që këto të mos evidentohen. Ky pasqyrim jo realist mund të çojë në konkluzioni e gabuar të uljes së numrit. Kështu, monitoruesve iu desha që këtë të dhëna ta vlerësojë në disa drejtime. Edhe gjatë tryezave me gjyqtarët e gjykatave të përfshira në monitorim u nënvizua se këto kërkesa janë rritur aq shumë sa që zënë një volum të madhe në punën e tyre. Kjo na bën të mendojmë se ndoshta mund të ketë edhe numër më të madh sa rezulton nga sa del nga monitorimi. Po kështu, argumenti që kanë përdorur avokatet e QNL është bazuar në verifikimet e UM dhe UMM në database-in e gjykatës. Ato kanë konstatuar raste kur urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes i përfaqësuar prej tyre nuk është pasqyruar në database-in e gjykatës si vendim. Kështu kemi disa raste të UM të verifikuara dhe nga përmbajtja e tij del se UM është rezultat i seancave të mëparshme të verifikimit të UMM dhe vetë ky UMM po ta kërkojmë në website në shumë raste nuk del i publikuar si vendim. Po rendisim si shembuj vendimet: Vendimi nr.1623/4.03.2011; Vendimi nr.813/09.02.2011; Vendimi nr.2316/12.03.2012. Monitorimi nuk nxori të dhëna krahasuese për gjykatat e tjera.

Gratë janë më të dhunuarat në familjet

Vazhdon të rezultojë se pjesëtari më i dhunuar në marrëdhëniet familjare është gruaja.

Kështu në 89% të rasteve nga vendimet e monitoruara për vitin 2011 në GjRrGj Tiranë, kërkesa për UMM/UM është paraqitur nga gratë. Gjithashtu, për Tiranën, në 92% të rasteve gjatë periudhës objekt monitorimi janar – 31 maj 2012, kërkesa për UMM/UM është paraqitur nga gratë. Nuk mungojnë rastet e padive të paraqitura nga burrat.

Gjykata	Periudha	Vendime UM/ UMM	UMM	UM	Paditës	
					Gra	Burra
Tiranë	2011	182	113 ose 62%	69 ose 38%	162 ose 89%	20 ose 11%
	1 janar-31 maj 2012	239	160 ose 67%	79 ose 33%	220 ose 92%	19 ose 8 %

Gjykata	Periudha	Vendime UM/ UMM	UMM	UM	Paditës	
					Gra	Burra
Durrës	2011	154	147 ose 95.4%	7 ose 4.6%	141 ose 91.5%	13 ose 8.5%
	1 janar-31 maj 2012	78	76 ose 97%	2 ose 3%	58 ose 87%	9 ose 13%
Vlorë	2011	27			27 ose 100%	0
	1 janar-31 maj 2012	54			51 ose 94%	3 ose 6%
Shkodër	2011	52	100 %	88.4 %	52 ose 100%	0
	1 janar-31 maj 2012	31	100 %	87 %	31 ose 100%	0

Për GjRrGj Durrës, në 91.5% të rasteve gjatë periudhës objekt monitorimi 1 janar-31 dhjetor 2011, kërkesa për UMM/UM është paraqitur nga gratë. Të njëjtin koment kemi edhe për vitin 2012, kuptohet aq sa zgjat monitorimi. Pra, në 87% të rasteve gjatë periudhës objekt monitorimi 1 janar-31 maj 2012, kërkesa për UMM/UM është paraqitur nga gratë.

Kryesisht UM/UMM edhe në GjRrGj Vlorë kërkohen nga gjinia femërore. Për vitin 2011, në të 27 paditë e ngritura, paditëse kanë qenë gratë dhe asnjë rast i kërkimit të urdhrimit të mbrojtjes nga burrat. Gjithsej për vitin 2012 janë monitoruar 54 urdhra mbrojtje. Në 51 raste paditëse kanë qenë gratë dhe vetëm në 3 raste kanë qenë burrat. Duhet të theksojmë se 3 rastet e padisë së ngritur nga burrat nuk kanë të bëjnë me urdhër mbrojtje ndaj grave, por me urdhër mbrojtjeje ndaj personave të tjerë të familjes. Kështu në të 3 rastet ka qenë babai që ka kërkuar urdhër mbrojtje ndaj djalit për shkak të dhunës që ai ushtronte, raste të tilla që kanë sjellë si pasojë e dhunës së fëmijëve ndaj prindërve. Kjo vinte si shkak sepse fëmijët vinin vonë në darkë në shtëpi, vinin të pirë apo nervoz për shkak të humbjes së lekëve në lojërat e fatit³². Dhe në përgjithësi gjykata vendoste në favor të kërkesës së grave të dhunuara duke detyruar bashkëshortët të qëndrojnë larg bashkëshorteve, të mos kryejnë veprime dhune dhe të paralajmëruar që në rast të shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes do të ngrihet çështje penale ndaj tyre për shkelje të urdhrave të mbrojtjes (parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal).

Në të gjitha vendimet e monitoruara për GjRrGj Shkodër, rezulton se paditëse është bashkëshortja dhe i paditur është bashkëshorti, gjë që sjell faktin që kërkesë padia është ngritur nga bashkëshortja. Për të gjithë periudhën e monitorimit, në 40 raste, denoncimi është bërë nga vetë viktimat nëpërmjet policisë. Në 43 raste, viktimat janë orientuar përmes sistemit të referimit siç janë organizatat që punojnë në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, bashkia, organet e rendit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për vitin 2011 ka lëshuar 52 urdhra të menjëhershëm të mbrojtjes. Nga këto 6 prej tyre ose 11.5 % janë pushuar në seancën e verifikimit të UMM. Në 46 raste ose për 88.4% Gjykata ka vendosur lëshimin e UM në seancën e verifikimit të UMM.

32 Për vitin 2013 në GjRrGj Vlorë janë monitoruar 6 urdhra mbrojtjeje nga të cilat janë pranuar 3 dhe janë pushuar 3. Në këto 6 raste, 5 padi i kanë ngritur gratë dhe vetëm 1 është ngritur nga burrat. Rasti i vetëm që një burrë ka paraqitur padinë për urdhër mbrojtje është rasti i vjehrrit ndaj dhëndrit. Të dy jetonin në një shtëpi dhe dhëndri e dhunonte gjithmonë vjehrrin për shkak të debateve që ata bënin me njëri tjetrin. Në këto kushte vjehrrin i është drejtuar gjykatës dhe ka përfituar urdhër mbrojtjeje.

Kjo gjykatë për vitin 2012 ka lëshuar 31 urdhra të menjëhershëm të mbrojtjes. Nga këto 4 prej tyre ose 12.9 % janë pushuar në seancën e verifikimit të UMM. Në 27 raste ose për 87 % Gjykata ka vendosur lëshimin e UM në seancën e verifikimit të UMM.

Ende janë të larta rastet e vendimeve të pushimit për UM/UMM në përgjithësi dhe të atyre ku gratë janë paditëse në veçanti

Kështu, për vitin 2011, nga 182 vendime të lëshimit të UMM/UM nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 111 raste ose 61% të rasteve, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes. Pra, ka vetëm 71 vendime për UM/UMM. Nga 111 vendime pushimi, në 101 prej tyre ose ne 91% të rasteve kërkesa për UMM/UM është bërë nga gratë. Për vitin 2012, në GjRrGj Tiranë, nga 239 vendime të lëshimit të UMM/UM nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 154 raste ose 64% të rasteve gjykata ka vendosur pushimin e çështjes dhe ka dhënë UM/UMM në 85 raste. Nga 154 vendime pushimi, në 143 prej tyre ose në 92% të rasteve kërkesa për UMM/UM është bërë nga gratë.

Për GjRrGj Durrës, në rreth 84% të vendimeve të pushimit urdhri është kërkuar nga gratë. Nga 154 vendime të lëshimit të UMM/UM nga GjRrGj Durrës për vitin 2011, në 58 raste ose 37.6% të rasteve gjykata ka vendosur pushimin e çështjes. Nga 58 vendime pushimi, në 49 prej tyre ose ne 84,5% të rasteve kërkesa për UMM/UM është bërë nga gratë. Për vitin 2012, nga 78 vendime të lëshimit të UMM/UM nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës të monitoruara në total, në 31 raste ose 39.7% të rasteve gjykata ka vendosur pushimin e çështjes. Nga 31 vendime pushimi, në 26 prej tyre ose ne 83,8% të rasteve kërkesa për UMM/UM është bërë nga gratë.

Në GjRrGj Vlorë, gjatë vitit 2011 janë monitoruar 27 urdhra mbrojtjeje. Nga këto 19 kërkesa janë pranuar ose 70%, 4 janë pushuar ose 15% dhe 4 janë rrëzuar ose 15%. Duket se gjykata kur i gjen pretendimet të bazuara në prova vendos lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësen. Për vitin 2012, nga 54 kërkesa për UM, janë pranuar 40 padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose 74%, janë pushuar 10 padi ose 19% dhe janë rrëzuar 4 padi ose 7%.

Gjinia e paditësit/es në vendimet e pushimit sipas gjykatave të monitoruara

Gjykata	Periudha	Vendime UMM/UM	Vendime UMM/UM		Gjinia e paditësit/es në vendimet e pushimit	
			Vendime pushimi	Vendime të lëshimit të UMM/UM	Gra	Burra
Tirana	2011	182	111	71	101	10
	1 janar -31 maj 2012	239	154	85	143	11
Durrës	2011	154	58	96	49	9
	1 janar -31 maj 2012	78	31	47	26	5
Vlorë	2011	27	8	19		
	1 janar -31 maj 2012	54	14	40		
	2011	52	6	46	52	-
Shkodra	1 janar -31 maj 2012	31	4	27	31	-

Shkaqet e pushimit të çështjes

Për GJRRGJ Tiranë, për vitin 2011, nga 111 vendime pushimi janë 78 vendime ku çështja është pushuar për mosparaqitje te paditësit edhe pse ka marrë dijëni. Nga këto 78 vendime pushimi për këtë shkak, në 70 vendime paditëse ka qenë gruaja si bashkëshorte. Ndërsa në 33 vendimet e tjera të pushimit, pushimi i çështjes ka ndodhur për shkaqe të tjera, psh: paditësja është paraqitur në seancë dhe ka deklaruar se heq dorë nga kërkesa (6 raste), ka hequr dorë nga gjykimi për shkak të normalizimit të marrëdhënieve (8 raste), i padituri ka bërë deklaratë përpara gjykatës që nuk do e dhunojë më [në 8 raste] etj. Për periudhën 1 janar - 31 maj 2012, nga 154 vendime pushimi, janë 96 raste të pushuara për mos paraqitje pasi paditësi/ja ka marrë dijëni sipas Gjykatës dhe nga këto, në 88 raste padija është bërë nga gratë. Ndërsa në 58 vendimet e tjera të pushimit, pushimi i çështjes ka ndodhur për shkaqe të tjera, psh: paditësja është paraqitur në seancë dhe ka deklaruar se heq dorë nga kërkesa (17 raste), ka hequr dorë nga gjykimi për shkak të normalizimit të marrëdhënieve [13 raste], i padituri ka bërë deklaratë përpara gjykatës që nuk do e dhunojë më [në 19 raste] etj.

Në lidhje me shkaqet e pushimit nga monitorimi i vendimeve të **GjRrGj Durrës** ka rezultuar se për vitin 2011 në 23 raste, paditësja është paraqitur në seancë dhe ka deklaruar se heq dore nga kërkesa; në 35 raste të pushuara pasi paditësi ka marrë dijëni sipas gjykatës. Në 26 raste ose 74.3 % janë gra, paditëse të cilat nuk janë paraqitur. Për vitin 2012, sipas periudhës së monitorimit, në 12 raste, paditësi është paraqitur në seancë dhe ka deklaruar se heq dore nga kërkesa; 1 rast, paditësja ka hequr dore pasi dhunuesi ka bërë deklaratë përpara gjykatës se nuk do të ushtrojë dhunë; në 21 raste të pushuara pasi paditësi ka marrë dijëni sipas gjykatës. Ndër këto vendime, në 16 raste janë gra të cilat nuk janë paraqitur.

Për GjRrGj Vlorë, ndër shkaqet e pushimit kemi mosparaqitja e paditësit në seancën gjyqësore ndërsa në rastet e rrëzimit pala paditëse nuk ka provuar pretendimet në lidhje me dhunën qoftë fizike, qoftë psikike. Mendojmë se përtej të drejtës për të hequr dorë nga kërkesa për lëshimin e UMM/UM qëndrojnë problematika të shumta sociale.

Për GjRrGj Shkodër, përgjithësisht, shkaqet për pushimin e UM, lidhen me procesin e të provuarit. Në përgjithësi, të gjitha kërkesë paditë për vendosjen e UMM, pranohen. Vështirësia lind në momentin e provimit të UM (në katër raste nuk është bërë ekspertimi mjeko ligjor, duke vështirësuar procesin e provimit; në një rast bëhej fjalë për dhunë emocionale (shumë herë e vështirë për t'u provuar, pasi bazohet vetëm në bindjen e brendshme të gjyqtarit), dhe në dy raste, vetë viktimat ka kërkuar pushimin e UM.

Edhe fëmijët janë subjekte për të cilët kërkohet mbrojtje nga dhuna


Për vitin 2011, nga 71 vendime të lëshimit të UMM/UM nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 26 prej tyre ose në 36.5% është kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët. Nga 85 vendime të lëshimit të UMM/UM nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në 26 prej tyre ose 30.5% është kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët.

Nga 96 vendime të lëshimit të UMM/UM nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për vitin 2011, në 16 prej tyre ose në 13% është kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët. Për vitin 2012, nga 54 vendime të lëshimit të UMM/UM nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në 10 prej tyre ose 19 % është kërkuar mbrojtje edhe për fëmijët.


Rezulton që në rastet e ndjekura nga OJF-të Shkodër, që nga momenti që bëhet denoncimi në organet e rendit, edhe kur fëmijët kanë qenë viktimat të dhunës së asistuar, janë vënë si subjekte të cilët kërkojnë mbrojtje nga dhuna. Duke proceduar në këtë mënyrë, është tuteluar interesi më i lartë

i fëmijëve, duke siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien psikologjike të tyre. Janë 4 vendime ku fëmijët rezultojnë kërkues së bashku me nënën e tyre në këtë gjykatë.

Marrëdhënia midis dhunuesit dhe viktimës shënon në nivel më të lartë dhunën ndërmjet bashkëshortëve dhe ish bashkëshortëve



Nga monitorimi i vendimeve të të gjitha gjykatave rezultoi se në lidhje me marrëdhënien midis dhunuesit/viktimës ka rezultuar se në përqindjen më të lartë të rasteve është marrëdhënia midis bashkëshortëve, e ndjekur nga marrëdhënia midis ish-bashkëshortëve. Ka rezultuar se subjekte të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare për të gjithë periudhën e monitorimit kanë qenë edhe ish-bashkëjetues, ish-partnerë dhe ish-të fejuar.



Nga analiza e vendimeve gjyqësore, duam të nënvizojmë se nuk kemi mundur të kuptojmë të dhëna në lidhje me marrëdhënien midis dhunuesit dhe viktimës për të gjitha vendimet e pushimit.

Tabela në vijim na jep të dhëna në lidhje me marrëdhënien midis palëve sipas gjykatave të monitoruara.

Gjykata	Periudha	Totali	Marrëdhënia familjare						
		Vendime të lëshimit të UMM/UM	Bash-këshort	Ish-bash-këshort	Bashkë-jetues	Ish-bashkë-jetues	Ish-partner	Ish-të fejuar	Të tjerë
Tirana	2011	71	36	8	6	2	1	2	16
	1 janar-31 maj 2012	85	47	9	1	1	-	-	27
Durrës	2011	96	31	23	4				38
Shkodra	2011	52	50	2	-	-	-	-	-
	1 janar-31 maj 2012	31	30	1	-	-	-	-	-

Tabela më sipër na jep të dhëna në lidhje me marrëdhënien midis palëve.

IV

Gjetje paraprake nga monitorimi i vendimeve gjyqësore penale

4.1. Çështjet me objekt zbatimin e nenit 130/a,” Dhuna në familje” të KP, të ndryshuar.

Me ligjin nr. 23/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895/27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhuna në familje parashikohet si vepër penale e veçantë në nenin 130/a³³.

Lidhur me këtë vepër, monitorimi është fokusuar për periudhën prill-dhjetor 2012, pra, pas hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi e për rrjedhojë zbatimit të këtij neni të KP. Gjetjet kryesore duket se çojnë në këto konkluzione.

Lidhur me praktikën e GjRrGj Tiranë, kemi konstatuar:

- janë paraqitur 26 raste përpara gjykatës por në 17 prej tyre gjykata ka dhënë vendime pushimi.
- Të gjithë të dënuarit, pra në 9 çështjet e përfunduara, për kryerjen e veprës penale të dhunës në familje, janë meshkuj.
- Analiza e vendimeve ka rezultuar se gjykata ka dhënë vendimin e pushimit për të 17 rastet në zbatim të ligjit nr.107/2012 “Për dhënie amnistie”.
- Lidhur me masën dhe llojin e dënimit vëmë re se: Ndër 9 të dënuar, gjykata penale në 7 raste ka dhënë dënim me burg, duke aplikuar nenin 406 të K.Pr.Penale dhe në 2 raste gjykata ka vendosur dënimin me kohë prove.

Periudha e monitorimit	Vendime, neni 130/a	Vendime pushimi	Të dënuar	Zbatuar neni 406 i P.Pr.Penale		
				burg	kohë prove	
31.04.- 31.12.2012	26	17	9	7	2	7

33 **Neni 130/a KP: Dhuna në familje:** [1]Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. [2] Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. [3] Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paafësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. [4] Po këto vepra të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen me burgim nga një vit gjer në pesë vjet.”

- Në lidhje me marrëdhënien midis dhunuesit dhe viktimës ka rezultuar se në 7 raste dhuna ka ndodhur midis bashkëshortëve, në një rast në marrëdhëniet fëmijë/prind dhe në një rast në marrëdhënie të tjera.

Nga monitorimi i vendimeve të GjRrGj Durrës, rezulton se kemi 7 vendime lidhur me nenin 130/a të K.P.

4.2. Gjetjet nga monitorimi i zbatimit të Nenit 320 të Kodit Penal “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” dhe Nenit 321 të Kodit Penal “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës”, i ndryshuar.

GjRrGj Tiranë

Per vitin 2011: Totali 11 vendime

Neni 320 ka gjithsej 10 vendime.

Neni 321 ka gjithsej 1 vendim

Per vitin 2012: Totali 20 vendime

Neni 320 ka gjithsej 16 vendime

Neni 321 ka gjithsej 4 vendime

Monitorimi ka sjellë rezultate vetëm për GjRrGj Tiranë. Duke qenë se objekt i monitorimit janë edhe disa vepra penale që lidhen me elemente gjinore u ndalëm në disa prej neneve të Kodit Penal. Kështu, Tabela në vijim jep të dhëna në lidhje me numrin e të dënuarve për kryerjen e këtyre veprave penale, llojin e dënimit dhe gjininë e të dënuarve.

Viti	Vendimet e monitoruara	Të dënuar		Lloji i dënimit dhe të tjera					
		Burrë	Grua	Burg	Gjobë	kohë prove	pafajësi	kthim akti	Amnisti
2011	11	9	2	2	8	-	1	-	-
2012	20	16	1	2	9	5	1	1	2

- *Gjinia e personit të akuzuar/dënuar:* Për këto lloj veprash, të dënuarit janë më së shumti meshkujt. 92% për 2011 dhe 94% për 2012.
- *Lloji dhe masa e dënimit:* Konstatohet se dënimet me burg [18% të totalit të rasteve për të dy vitet] përbëjnë një numër të ulët të rasteve krahasuar me llojet e tjera të dënimit.
- *Marrëdhënia familjare viktimë - dhunues:* Rezulton se kemi një rritje të rasteve, ku marrëdhënia midis të dënuarit dhe viktimës është marrëdhënie bashkëshortore [12 vendime për gjithë periudhën ose 43 %]. Në të njëjtën vlerë qëndron edhe marrëdhënia mes ish bashkëshortëve [12 raste për gjithë periudhën ose 43%] dhe mandej midis ish bashkëjetuesve [2 raste për të gjithë periudhën ose 14%].

Tabela në vijim jep të dhëna në lidhje me marrëdhënien familjare midis të dënuarit dhe viktimës sipas GjRrGj Tiranë

Neni 320&321 i K.P	Marrëdhënia familjare				
	Bashkëshort	Ish-bashkëshort	Ish-bashkëjetues	Bashkëjetues	Të tjera
11	2	6	1	-	2
20	10	6	1	-	3

4.3. Gjetje nga monitorimi i vendimeve penale lidhur me zbatimin e nenit 113 i K.Penal “Prostitucioni” ndryshuar

Ligji nr. 23/2012 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë të ndryshuar bëri ndryshime për nenin 113 të K. Penal me përmbajtjen ”Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”. Ndryshimi i KP ka hyrë në fuqi në datën 13 prill 2012. Nga monitorimi dalin këto gjetje kryesore:

- *Për ‘prostitucion’ dënohen vetëm gratë:* Për GjRrGj Tiranë: nga monitorimi i vendimeve penale për veprën penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni” për vitin 2011 ka rezultuar se kjo gjykatë ka dhënë gjithsej 15 vendime dhe ka dënuar për këtë veprë penale 17 gra. Për vitin 2012 ka rezultuar nga monitorimi se janë dhënë gjithsej 12 vendime dhe janë dënuar 13 femra. Për GjRrGj Durrës: për vitin 2011 ka vetëm një vendim ku për këtë veprë është dënuar një femër dhe për vitin 2012 kemi 5 vendime penale nga të cilat në 4 vendime kemi të dënuara 4 femra dhe në 1 prej tyre është një mashkull³⁴.
- *Lloji dhe masa e dënimit: burg/gjobë.* Ka rezultuar nga monitorimi i vendimeve penale në GjRrGj Tiranë se për gratë e dënuara për prostitucion ka një politike dënimi më të ashpër, që do të thotë se ka më shumë gra të dënuara me burg dhe vetëm në një numër prej 7 rastesh për gjithë periudhën dënimi është dhënë me kohë prove.

Viti	AKUZA	E DENUARA	DËNIMI				TE PAFAJSHEM
		GRUA	BURG	GJOBË	KUSHT	NENI 406	
2011	Neni 113	17	8	9	6	17	0
			47.1%	52.9%			
2012	Neni 113	13	5	6	1	4	2
			38.4%	46.1%			15.3%

Ka rezultuar nga monitorimi se për vitin 2011 janë dënuar me burgim 8 gra dhe nga këto në 6

34 Nga monitorimi i veprave të tjera në këtë gjykatë kemi këto të dhëna: për vitin 2011, Neni 114 – Shfrytëzimi i Prostitucionit – 2 raste, 1 femër, 1 mashkull. Neni 114/a – Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana renduese – 1 rast ku personi i dënuar është mashkull. Për vitin 2012, Neni 114 – Shfrytëzimi i Prostitucionit – kemi 3 raste, nga të cilat në 2 raste është dënuar femër, dhe në 1 rast mashkull. Neni 114/a – Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana renduese – 1 rast mashkull.

raste është aplikuar zbatimi i nenit 59 i Kodit Penal ³⁵ ky dënim është dhënë me kohë prove. Masa e dënimit me burg e dhënë nga gjykata ndaj grave për këtë veprë penale varion nga 2 muaj deri në 4 muaj. Ndërsa në 9 raste gjykata ka dhënë llojin e dënimit ndaj grave me gjobë e cila varion nga 66.000 lek deri në masën 200.000 lek. Për të gjitha rastet gjykata ka zbatuar nenin 406 të K.Pr.P, duke zhvilluar gjykim të shkurtuar.

Ndërsa për vitin 2012 ka rezultuar se janë dënuar me burgim 5 gra dhe nga këto në 1 rast është aplikuar zbatimi i nenit 59 K.P ky dënim është dhënë me kohë prove. Masa e dënimit me burg e dhënë nga gjykata ndaj grave për këtë veprë penale varion nga 20 ditë deri në 4 muaj. Ndërsa në 6 raste gjykata ka dhënë llojin e dënimit ndaj grave me gjobë e cila varion nga 70.000 lek deri në masën 300.000 lek. Në këto raste gjykata ka zhvilluar gjykim të shkurtuar në bazë të nenit 406 të K.Pr.P. Në dy raste gjykata ka dhënë pafajësi.

Përfaqësimi me Avokat

Për GjRrGj Tiranë, në lidhje me përfaqësimin me avokat ka rezultuar se të pandehurat për vitin 2011, janë përfaqësuar me avokat në 76.4 % të rasteve dhe nuk janë përfaqësuar me avokat në 23.6 %. Është e evidente se nga 13 rastet e grave të dënuar për kryerjen e veprës penale të prostitucionit, të përfaqësuar me avokat, ka rezultuar se në 8 prej tyre ose në 61.5 %, të dënuar janë përfaqësuar me avokate femra, gjatë vitit 2012.

Viti	I/E pandehura	Av. Mashkull	Av. Femër	Av.Femër kryesisht	Av. Mashkull kryesisht	Nuk përfaqësohet	Totali
2011	Grua	3 raste	3 raste	7 raste	-	4 raste	17
%		17.6	17.6	41.1		23.6	
2012	Grua	2 raste	-	8 raste	2 raste	1 rast	13
%		23		53.8	15.3	7.6	

Mosha e të dënuarave për prostitucion pasqyron këto të dhëna

- 10% moshë e mitur;
- 20 % midis moshës 18-20 vjeç;
- 43.3% midis 21-30 vjeç

GRA	I MITUR	18-20	21-30	31-40	41-50	MBI 50	Totali
2011	-	5	8	2	1	1	17
2012	3	1	5	2	2	-	13
Total në nr	3	6	13	4	3	1	30
Total në %	10	20	43.4	13.3	10	3.3	100%

Të dhëna për GjRrGj Tiranë

35 Neni 59 i Kodit Penal "Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim" parashikon se: Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burgim gjer në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale po aq të rëndë apo më të rëndë. Afati i provës është tetëmbëdhjetë muaj gjer në pesë vjet.

Arsimi i të dënuarave:

- mbi 63% nga pa arsim ose deri në arsim 8 vjeçar.
- Rreth 13 % me arsim të mesëm.
- Për 23% nuk ka të dhëna lidhur me arsimin

GRA	PA ARSIM	FILLOR	8-VJECAR	I MESËM	I LARTË	NUK KA TË DHËNA	Totali
2011	4	1	5	2	-	5	17
2012	-	2	7	2	-	2	13
Totali në nr.	4	3	12	4	-	7	30
Totali në %	13.3	10	40	13.3	-	23.3	99.9

Në 40 % të rasteve, të dënuarat janë me arsim 8 vjeçar, të ndjekur në 13.3 % të rasteve nga të dënuarat me arsim të mesëm dhe pa arsim. Edhe këto të dhëna i referohen vetëm monitorimit për GjRrGj Tiranë.

T ë dhëna lidhur me vendlindjen: 83.3% me vendlindje në qytet dhe 13.4 në fshat

GRA	FSHAT	QYTET	SHTET TJETËR	Totali
2011	2	14	1	17
2012	2	11	-	13
Totali në nr	4	25	1	30
Totali në %	13.4	83.3	3.3	100

4.3.1. Analiza e një rasti konkret dhe dhënia e opinionëve juridike të QNL mbi antikushetutshmërinë e nenit 113 të KP: Rasti B.Q.

Proceset gjyqësore: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.744/06.05.2011, ka vendosur deklarin e B.Q si fajtor për kryerjen e veprës penale të “Prostitucionit”, parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1430/21.12.2011 ka vendosur lënin në fuqi të vendimit nr. 744/06.05.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka vendosur deklarin e B.Q. fajtor për kryerjen e veprës penale të “Prostitucionit”, parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal.

Rekursi në GJL: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare ka paraqitur recurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar pafajësinë e B.Q duke argumentuar si vijon:

Së pari, Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 1430 datë 21.12.2011 i cili ka vendosur lënin në fuqi të vendimit nr. 744 datë 6.5.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe pse është bazuar në një nga nenet e parashikuara shprehimisht në Kodin Penal, nuk është vendim i drejtë. E akuzuara pretendon se “Dënimi që më është dhënë nga Gjykata, gjithashtu, nuk është i drejtë”. Sikurse është pretenduar edhe në gjykim, parashikimi i dënimit për ushtrimin e prostitucionit, në mënyrën se si

është parashikuar në nenin 113 të Kodit Penal, e bën këtë nen antikushtetues.

Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe Gjykata e Apelit Tiranë nuk duhet që me vendimet e mësipërme, të deklaronin B.Q fajtorë për ushtrimin e prostitucionit, pa kryer më parë kontrollin incidental, duke kërkuar zbatimin e nenit 145/2 të Kushtetutës, për shqyrtimin e çështjes paragjykimore nga Gjykata Kushtetuese, e cila është gjykata kompetente për të vlerësuar nëse neni 113 i Kodit Penal “Prostitucioni”, vjen në kundërshtim me Kushtetutën.

Avokatja e QNL ka pretenduar si në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ashtu dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë se neni 113 i Kodit Penal vjen në kundërshtim me Kushtetutën e R.Sh dhe konkretisht, me parimin e barazisë gjinore të parashikuar nga neni 18 i saj. Kështu neni 113 i Kodit Penal, shkel parimin e barazisë gjinore, duke i diskriminuar gratë dhe vajzat tërthorazi, për shkak të gjinisë. Ndërsa objekt i kësaj figure janë marrëdhëniet juridike të vendosura për ndalimin e ushtrimit të prostitucionit, me qëllim mbrojtjen e moralit dhe të dinjitetit të personit, duket qartë se nga ana objektive, element thelbësor për këtë figurë krimi, është marrja e shpërblimit për ushtrimin e prostitucionit³⁶. Për rrjedhojë, subjekt i kësaj vepre penale, është personi që ka marrë shpërblim si rezultat i kryerjes së marrëdhënieve seksuale, gjë që i jep karakter diskriminues parashikimit ligjor në këtë vepër, për shkak se që ajo të kryhet duhet të ekzistojnë medoemos dy subjekte. Në këtë mënyrë, duhet theksuar se, në bazë të Kushtetutës, legjislatori duhet t’i mbrojë të gjithë qytetarët e tij në mënyrë të barabartë nga shkelja e dinjitetit.

Por, në këtë rast nuk ndodh kështu, pasi nuk është mbajtur parasysh se, veprimet kriminale me të cilat konsumohet kjo vepër penale, kryhen jo vetëm nga përfituesi i shpërblimit, por edhe nga personi që përfiton marrëdhënie seksuale, në mënyrë të paligjshme, si dhe nga persona të tretë që mund të përfitojnë në mënyra të ndryshme, si rezultat i ushtrimit të prostitucionit. Prandaj, si personi që ka përfituar marrëdhënie seksuale, edhe ai/ajo që kryejnë marrëdhënie seksuale kundrejt shpërblimit, mund të kenë shkelur normat e moralit shoqëror dhe kanë cenuar dinjitetin e personit. Por, kjo nuk do të thotë se, për këtë duhet të mbajë përgjegjësi vetëm personi që përfiton paratë, pasi edhe personi tjetër që i ka dhënë paratë kundrejt përfitimit seksual, ka shkelur normat e moralit shoqëror dhe dinjitetin e personit. Nëse qëllimi i ligjvënësit ka qenë që të mbrojë normat morale të shoqërisë, atëherë ai duhet të mbante parasysh faktin se dënimi për këtë vepër nuk mund të jetë diskriminues. Në këtë rast jemi përpara një diskriminimi të tërthortë, i cili në të njëjtën mënyrë me atë të drejtpërdrejtë e bën nenin antikushtetues.

Së dyti, Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin e saj megjithëse e konsideron ushtrimin e kontrollit incidental si një garanci të raportit të normës kushtetuese me atë ligjore, nuk ka argumentuar/arsyetuar pse nuk e ka ushtruar kontrollin incidental në këtë rast. Në nenin 145/2 të Kushtetutës është sanksionuar se “Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese”. Kjo nuk i jep të drejtën gjyqtarit që këtë të drejtë ekskluzive të atribuuar nga Kushtetuta ta përdori pa asnjë lloj arsytimi e argumenti si në vendimin nr. 1430/ 21.12.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Së treti, nëse do të mbanim parasysh interpretimin statistikor për të zgjidhur këtë çështje, ashtu sikurse veprojnë zakonisht gjykatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, rezulton, se në zbatim të kësaj dispozite penale, pothuajse të gjithë personat e dënuar kanë qenë gratë dhe vajzat të cilat kanë pranuar të hyjnë në marrëdhënie seksuale kundrejt shpërblimit dhe ofertës së kryer nga mashkulli, për shkak të vulnerabilitetit të tyre. Vulnerabiliteti i tyre, varfëria, papunësia, i fut gratë në një risk të

36 Shih: Ismet Elezi, “E drejta Penale. Pjesa e Posaçme”, Tiranë, 2009, fq. 153-155.

veçantë të dhunës e të abuzimit³⁷. Kjo duket qartë edhe nga mënyra se si është interpretuar vazhdimisht nga Gjykata dhe vazhdon të interpretohet konkretisht në rastin tim, ky nen. Praktika të tilla ligjore e gjyqësore, janë të papajtueshme me gëzimin e barabartë të respektit ndaj dinjitetit të gruas dhe gëzimin e barabartë të të drejtave prej saj.

Së katërti, Gjykatat përkatëse duhet ta çmonin këtë dispozitë, në kundërshtim me Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e cila është një konventë e ratifikuar nga Shteti Shqiptar. Kështu, Komiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në interpretim të nenit 6 të Konventës së CEDAW-t, pas raportimit periodik të fundit që Shteti Shqiptar paraqiti në OKB, i rekomandon qartazi Shtetit Shqiptar, që Kodi Penal të ndryshohet me qëllim që viktimat të mos i nënshtrohen ndjekjes penale dhe dënimit penal. Ky komitet ka ripërsëritur shqetësimin e tij të veçantë, që gjendet në vërejtjet e mëparshme përmbyllëse [A/58/38 (Supp), par.70], sipas të cilit, viktimat e trafikimit dhe prostitutat vazhdojnë t'i nënshtrohen dënimit penal në pajtim me kodin penal³⁸.

Në këto kushte, Gjykata duhet ta çmojë këtë dispozitë, në kundërshtim me Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e cila është një konventë e ratifikuar nga Shteti Shqiptar, prandaj në bazë të nenit 116 dhe 122 të Kushtetutës, ka epërsi mbi ligjet e brendshme të vendit. Për shkak të interpretimit që i ka bërë Komiteti i CEDAW-t kësaj konvente, sipas të cilit, sikurse e shpjeguem më sipër, shprehet shqetësimi për ndëshkimin e prostitutave në bazë të Kodit Penal, unë e konsideroj nenin 113 të Kodit Penal, si një dispozitë që vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Kjo për faktin se Komiteti i CEDAW-t është organi kompetent që mund të bëjë interpretimin përfundimtar të Konventës së CEDAW-t.

Së pesti, Një argument tjetër, buron edhe nga interpretimi krahasimor i dispozitës. Për këtë, mjafton të analizojmë përvojat në shtete të tjera në lidhje me këtë dispozitë. Vëmë re se në mjaft shtete, janë bërë reforma në Kodin Penal, qysh në vitet 1970 e në vijim, ku është shfuqizuar një dispozitë e ngjashme me nenin 113 të Kodit tonë Penal, nga legjislacionet e këtyre vendeve³⁹. Një qëndrim i tillë është mbajtur edhe nga doktrina shqiptare, e cila në interpretimin e këtij neni shprehet për nevojën e heqjes së tij⁴⁰.

QNL i kërkoi Gjykatës së Lartë: Deklarimin e B.Q. të pafajshme; Pezullimin e gjykimit, dërgimin e çështjes për shqyrtim përpara Gjykatës Kushtetuese, në zbatim të nenit 145/2 të Kushtetutës së R.Sh; Shpalljen e konfidencialitetit;

Aktualisht: Kjo çështje është në proces gjykimi pranë Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, QNL i është drejtuar njëkohësisht Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi me një informacion në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” [2010] dhe ka kërkuar shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal si diskriminues për gratë dhe vajzat.

Si rezultat edhe i kësaj ndërhyrje erdhën ndryshimet e Kodit Penal të vitit 2012.

37 Shih: Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19 të Konventës CEDAW, në zbatim të nenit 6, të Konventës kundër të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas.

38 Shih: “Vërejtje përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave”, sesioni i dyzet e gjashtë, 12-30 korrik 2010

39 Shih: “International approaches to decriminalizing or legalizing prostitution”, Tetor 2007, botuar në <http://www.procon.org>

40 Shih: Ismet Elezi, Po aty.

V

Monitorimi i praktikave të institucioneve të Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Avokatit të Popullit lidhur me barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin

Gjetjet nga monitorimi i vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund të përmbliidhen në vijim:

Ende ky institucion përdoret në mënyrë të kufizuar dhe veç kësaj duket se njohuritë për kuptimin diskriminimit dhe terrenet e mbrojtura është i kufizuara ose i gabuar apo pretenduesit nuk kanë njohurit të sakta e të plota. Monitorimi i KMD u realizua përmes raporteve vjetore të nxjerra nga ky institucion në Website-in zyrtar. Për vitin 2011 janë paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi 3 ankesa me pretendim për diskriminim për shkak të gjinisë. Në 2 prej tyre nuk është konstatuar diskriminim për shkak të gjinisë, ndërsa tjetra nuk është pranuar sepse nuk plotësonte kërkesat e ligjit nr. 10 221/04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për vitin 2012 janë paraqitur 2 ankesa me pretendim për diskriminim për shkak të gjinisë. Nga të cilët 1 ankese është pushuar për pamundësi të sigurimit të provave ndërsa tjetra është ende në proces shqyrtimi. Ndonëse në raportin e këtij institucioni thuhet se edhe në ankesa të tjera të shqyrtuara ka patur element të diskriminimit gjinor verifikimi i bërë nga stafi i QNL nuk gjeti diçka të tillë.

Gjetjet nga monitorimi i institucionit të Avokatit të Popullit:

Nga hulumtimi bërë në faqen zyrtare të këtij institucioni dhe raportin vjetor për vitin 2011 u vu re se raporti nuk hapet/aksesoret. QNL nuk mundi të konkludojë lidhur me ankesat me përmbajtje diskriminuese. Për vitin 2012 nga verifikimet e bëra raportit të këtij institucioni, nuk u gjetën ankesa që të përmbajnë diskriminim për shkak të gjinisë. Qëllimi i monitorimi ishte lidhur me aksesueshmerinë e të dhënave në faqen elektronike të këtyre institucioneve.

Bibliografi dhe baza ligjore

- Konventa e CEDAW [Ligji 1769/ 9.11.1993]
- LIGJ Nr. 104/2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- Protokolli 7 i KEDNJ dhe përkatësisht neni 5 i tij
- Protokolli 12 i KEDNJ, përkatësisht neni 1 i tij
- Ligji “Mbi barazinë gjinore në shoqëri” [Ligji Nr.9970/28.7.2008]
- Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” [Ligji nr. 221/4.2.2010]
- Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” [Ligji Nr.9669/18.12.2006, ndryshuar].
- Ligji “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” [Nr.10 347/4.11.2010]
- Kodi Penal i RSH ndryshuar
- Studimi “Të drejtat pronësore të grave” përgatitur nga Arta Mandro dhe mbështetur nga UNWomen, në proces botimi.
- Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, Tiranë, 2010.
- Ismet Elezi, “E drejta Penale. Pjesa e Posaçme”, Tiranë, 2009, fq. 153-155.
- Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19 të Konventës CEDAW, në zbatim të nenit 6, të Konventës kundër të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas. CEDAW.
- ”Vërejtje përmbyllëse të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave për Shqipërinë”, sesioni i dyzet e gjashtë, 12-30 korrik 2010
- “International approaches to decriminalizing or legalizing prostitution”, Tetor 2007, botuar në <http://www.procon.org>

Faqe në web

<http://hudoc.echr.coe.int>.

<http://www.gjykatatirana.gov.al/>

<http://www.justice.gov.al/>

<http://www.kmd.al/>

<http://www.avokatipopullit.gov.al/>

<http://www.gjykataelarte.gov.al/>

